

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5598
E mërkurë, 10 tetor 2018
çmimi 0.40 €

Haradinaj nuk ndryshon qëndrim: Korrigjimi i kufirit, opsion i vdekur



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

**A PO RESPEKTOHEN
MJAFTUESHËM TË DREJTAT E
PERSONAVE ME ÇRREGULLIME
MENDORE NË KOSOVË?! F. 11**

KMDLNj



**I JEPET LAMTUMIRA
E FUNDIT GAZETARIT
IBRAHIM REXHEPI F. 8**

**MIRATOHET RAPORTI PËR
KOSOVËN, SHOLTES PËRMEND
SHANSIN E MADH PËR VIZAT**

F. 3

EKONOMI

**MINISTRI SHALA
FUNKSIONALIZON
OBJEKTET E MTI-së F. 8**

**NJAZI THAQI: KEK-u,
ADRESË E NGRITJES
PROFESIONALE PËR
KUADROT E REJA F. 9**

KULTURË

**PËR LETRAT E ROBIT NË
DUAR TË NJERËZVE, TË
ENGJËJVE DHE TË ZOTIT F. 6**

B. ARMAGEDONI

SPORT

**KOSOVA ZHVILLON
STËRVITJEN E DYTË,
OPTIMIZËM PËR REZULTAT
POZITIV F. 16**



FLET PËR "EPOKËN E RE", BLERIM KUÇI F. 4-5

Nuk u frikësohemi kërcënimeve për rrëzimin e Qeverisë

Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Blerim Kuçi, ka bërë me dije se koalicioni qeverisës është duke funksionuar siç duhet dhe partnerët e tij kanë raporte të mira. Ai ka thënë se nuk u frikësohen kërcënimeve të presidentit Thaçi për rrëzimin e

Qeverisë dhe për zgjedhje të reja. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Kuçi ka deklaruar se deklaratat e tilla më tepër kanë për qëllim faktorizimin e Thaçit në këto procese. Sipas tij, presidenti Thaçi nuk duhet të bëhet xheloz me sukseset e

Qeverisë Haradinaj meqë ato janë edhe suksese të Kosovës. Pavarësisht prej kundërshtimeve, Kuçi ka treguar se Qeveria e mbështet vazhdimin e procesit të dialogut por, sipas tij, Kuvendi duhet të ketë rol kyç nëpërmjet mekanizmave monitorues

QEVERIA E KOSOVËS KA MBAJTUR MBLEDHJEN E RADHËS

Qeveria merr vendim për kompensimin e punës jashtë orarit për Policinë

Qeveria e Kosovës ka miratuar vendimin për kompensimin e punës jashtë orarit për Policinë e Kosovës. Shuma e ndarë është 2 milionë e 600 mijë euro dhe është bërë me qëllim të ruajtjes së performancës, efikasitetit dhe efektivitetit për arritjen e objektivave kushtetuese dhe ligjore të Policisë së Kosovës F. 7



Thaçit i kërkohet ta kthejë procesin e listave të veteranëve në pikën zero

F. 7



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Shqipëria synon masa të rrepta për siguri dhe krim të organizuar

Pas mbledhjes së Qeverisë të mbajtur të martën, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në një konferencë me gazetarë ka treguar për pesë vendimet dhe masat e marra nga qeveria për ndryshimet ligjore sa i përket sigurisë dhe krimit të organizuar



TIRANË, 9 TETOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, pas mbledhjes së qeverisë të martën, në një konferencë për media u deklarua për pesë vendimet dhe masat e marra nga qeveria për ndryshimet ligjore sa i përket sigurisë dhe krimit të organizuar. Ai ka thënë se Qeveria ka marrë iniciativë ta forcojë sigurinë në shkollë, duke shtuar oficerë sigurie në 150 shkollë, duke siguruar një hallkë të munguar në funksion të mbrojtjes së fëmijëve nga hyrja në kanalet e lëndëve narkotike deri në funksion të parandalimit të fenomeneve të dhunës apo bullizmit. "Kemi vendosur ta nisim zbatimin e programit të ri për oficerët e sigurisë në shkollat e vendit. Fillimisht ky program u pilotua me rezultate të kënaqshme të konfirmuara nga komuniteti i mësuesve, nga komuniteti i prindërve dhe nga Policia e shtetit. Nga 15 shkollat tani do të shtrihet në 150 shkollë -

gjimnaze kryesisht, ku do ta fillojnë punën menjëherë 150 oficerë sigurie të trajnuar enkas për këtë program", ka bërë të me dije kryeministri.

Qeveria e Shqipërisë, po ashtu, ka vendosur të ndërmarrë një ndryshim ligjor për të dyshuarit apo për të dënuarit të përfshirë në krim të organizuar apo edhe organizata terroriste, të cilët do t'i nënshtrohen një regjimi të ri shumë të rreptë izolimi dhe monitorimi, duke iu ndërprerë çdo lloj komunikimi i brendshëm dhe i jashtëm për të gjithë kohën e paraburgimit dhe të vuajtjes së pjesës së dënimit.

Një masë tjetër sigurie që ka vendosur qeveria, është ngritja e një salle operative monitorimi non-stop me kamera në burgjet e sigurisë së lartë. Kjo, ka deklaruar kryeministri, "garanton që burgjet janë vende dënimi, jo vende ku komandohet bota e krimit".

Ligjit ekzistues, që thotë se duke nisur nga data 31 dhjetor i këtij viti do të pushojnë së funksionuari të gjitha kazinotë elektronike, iu shtua ndryshimi i ri që përfshin edhe bastet sportive.

Kryeministri Rama ka shtuar: "Në zbatim të ligjit ekzistues, që ndalon reklamimin e kompanive të basteve, dhe që është shkelur nga të gjitha mediat pa përjashtim, unë i paralajmëroj të gjithë që brenda 24 orëve t'i heqin të gjitha reklamat nga ekranet, nga radiot, nga gazetatat apo nga portalet".

Qeveria, po ashtu, ka nisur draftimin e një pakete ndryshimesh në Kodin Penal për "të fortët". Rama ka thënë se duke qenë se bëhet fjalë për ndryshime

të Kodit Penal, këtë paketë do ta ndajnë me opozitën, ku i bëri thirrje të kthehet "nga bota e filmave në terrenin e përballjes reale me kriminalitetin". Megjithatë, Lulzim Basha, kryetar i partisë më të madhe opozitare të Shqipërisë, Partia Demokratike, ka deklaruar se vendi ka Ligjin Anti-mafia që është në fuqi prej vitit 2008, por ai nuk vepron.

Ai ka shtuar se krimi në Shqipëri po inkurajohet dhe po motivohet duke thënë se "sot në Shqipëri nuk sundon forca e ligjit, por forca e krimit". "Kemi një shkatërrim total të organeve të zbatimit të ligjit. Të policisë dhe prokurorisë. Arsyeja kryesore është mungesa e vullnetit të Qeverisë për ta luftuar

krimin. Kjo Qeveri nuk ka vullnet për ta luftuar krimin. Krimi tolerohet, lejohet dhe mbështetet nga Edi Rama dhe gjithë struktura që ai drejton", është shprehur Basha. Vendimi i Qeverisë së Shqipërisë për këto masa më të shtrenguara për luftimin e krimit të organizuar dhe shtimin e sigurisë në vend, vjen pak ditë pasi opozita e Shqipërisë përpiloi një "Paketë anti-mafia", ku synojnë ndryshim në Ligjin anti-mafia. Ndryshimet në këtë ligj, sipas tyre, janë kundër korrupsionit dhe oligarkisë. Qëllimi i kësaj pakete është goditja e korrupsionit dhe abuzimit me pushtetin, mbrojtja e pasurisë publike dhe garantimi i konkurrencës së lirë. (rel)

Arrestohen sulmuesit e dyshuar të shqiptarëve në Novi Sad



Novi Sad, 9 tetor - Ministri i Punëve të Brendshme i Serbisë, Nebojsa Stefanoviq, ka thënë të martën se policia e Novi Sadit ka arrestuar katër persona të dyshuar për sulm ndaj dy të rinjve shqiptarë, të cilët janë rrahur në natën midis së shtunës dhe të dielës në këtë qytet. "Policia, pas hetimeve intensive disaorëshe, i ka identifikuar të gjithë sulmuesit që kanë rrahur dy të rinjtë dhe ka arrestuar katër të dyshuar për këtë vepër penale", ka deklaruar Stefanoviq, raporton Shërbimi i Ballkanit i "Radios

Evropa e Lirë".

Stefanoviq ka thënë se "edhe pse hetimet e deritashme, përfshirë bisedat me të dyshuarit dhe njërin prej viktimave, tregojnë se incidenti nuk është nxitur në baza kombëtare, policia do t'i hetojë të gjitha akuzat në detaje dhe do të vijë deri tek e vërteta".

Një nga të rinjtë që është rrahur dhe plagosur keq është operuar në Qendrën Klinike të Vojvodinës dhe gjendja e tij shëndetësore raportohet të jetë stabile.

Këtë sulm e kanë dënuar institu-

cionet e Kosovës dhe të Shqipërisë. Po ashtu, sulmin e kanë dënuar edhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, qeveria e Vojvodinës, parti të opozitës dhe organizata joqeveritare.

Policia e Novi Sadit ka njoftuar se të arrestuarit janë V. R. (22), D. R. (23), M. Z. (19) dhe J. P. (24) dhe se ata akuzohen për sjellje të dhunshme dhe shkakim të plagëve të rënda trupore. Atyre iu caktua masa e paraburgimit prej 48 orësh, pas së cilës do të dërgohen në prokurorinë kompetente në Novi Sad.

Kryeministri Rama refuzon ofertën serbe për blerjen e Telekomit

TIRANË, 9 TETOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se nuk është në preferencën e Qeverisë shqiptare investimi në Telekom Albania nga ana e Kompanisë serbe të Telekomit. "Qëndrimi i Qeverisë shqiptare është shumë i thjeshtë dhe i qartë: bizneset serbe janë të mirëpritura në Republikën e Shqipërisë, por

në këtë sektor strategjik nuk është preferenca jonë", ka thënë Rama në një konferencë për media pas mbledhjes së Qeverisë.

Telekomi i Serbisë kishte shfaqur interesimin për blerjen e Telekom Albania, të cilën e ka nxjerrë në shitje "Deutsche Telekom". Kryeministri Rama ka thënë se Qeveria shqiptare nuk është pjesë

e transaksionit që do të kryejë një kompani private si "Deutsche Telekom", e cila, sipas tij, ka një strategji që të tërhiqet nga tregjet e vogla. Lidhur me këtë çështje ka folur edhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, i cili ka thënë se do të bisedojë për këtë çështje me kryeministrin shqiptar Edia Rama.



Haradinaj nuk ndryshon qëndrim: Korrigjimi i kufirit, opsion i vdekur!



Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë të martën se qëndron prapa deklaratave, se korrigjimi i kufirit me Serbinë është opsion i vdekur. Kreu i ekzekutivit i është përgjigjur presidentit Hashim Thaçi edhe sa i përket largimit të Haradinajt nga posti i kryeministrit. "Kush e ka ndërmend ta rrëzojë Qeverinë nuk flet, e rrëzon. Ata që flasin, mos u mërzitni për ta", ka deklaruar Haradinaj

vendi", ka thënë Haradinaj. Një ditë më herët Haradinaj është kritikuar nga presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, për këto deklarata, duke ia bërë me dije Haradinajt se duhet t'i korrigjojë ato. "Dialogu nuk ka vdekur, përkundrazi është në një fazë të rëndësishme. Është deklaratë interesante nga ana e kryeministrit dhe kjo tregon se (ai) ose është në humor të mirë, ose

ndihet tepër komod në karrigen e vet. Kam pritur nga kryeministri që të jetë më racional dhe i përgjegjshëm në deklaratat për qëndrimet e veta lidhur me dialogun. Një kryeministër serioz nuk flet çdo ditë për luftëra dhe tragjedi, por zhvillon prioritetet dhe angazhimet për reforma. Nuk jam fare i shqetësuar për deklarata populiste apo elektorale pa asnjë

pëmbajtje sepse, tekefundit, do ta luaj rolin tim udhëheqës në bazë të mandatit tim kushtetues dhe ligjor të obligimeve të mia në procesin e dialogut dhe në asnjë rrethanë nuk do t'i ushtroj ato kompetenca që nuk më takojnë", kishte thënë Thaçi. Në të kundërtën, Thaçi kishte paralajmëruar e krerët e institucioneve se edhe mund të largohen nga postet aktuale.

**EPOKA
ERE****Muhame KOCI**

PRISHTINË, 9 TETOR - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, vazhdon të insistojë se ndryshimi i kufirit Kosovë - Serbi është opsion i vdekur. Një ditë pasi presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka paralajmëruar kryeministrin se deklaratat e tilla mund ta largojnë atë nga posti i kryeministrit, kreu i ekzekutivit ka thënë se nuk frikësohet nga rrëzimi i Qeverisë. "Kush e ka ndërmend ta rrëzojë Qeverinë nuk flet, e rrëzon. Ata që flasin, mos u mërzitni për ta. Ai që ka vdekur nuk ngjallet më. Njëherë ka ndodhur që është ngjallur Krishti, po çështja e korrigjimit të kufijve, e shkëmbimeve të territoreve, ka vdekur!", ka thënë Haradinaj. Ai ka bërë me dije se çështja e ndryshimit të kufijve mund të ringjallë vetëm ndonjë skenar të dhunës në veri të vendit. "E vetmja mënyrë që kjo temë të mbahet gjallë është përmes ndonjë skenari të dhunës, gjoja në veri, apo të ndonjë incidenti e ndonjë sulmi të ndërsjellë, në mënyrë që pastaj të konfirmohet ndarja. Por, nuk ka mundësi politike më në tavolinë ky opsion sepse e kanë kuptuar të gjithë se është temë e vdekur. Me këtë, fatmirësisht, kemi fituar të gjithë, në radhë të parë i gjithë populli i Kosovës, shqiptarët, serbët, pakicat e tjera, i gjithë rajoni. Besoj se ka fituar paqja dhe dialogu. Jam i interesuar që dialogu të vazhdoj. Mendoj se kemi nevojë për dialog,

paqe dhe stabilitet në vendin tonë", është shprehur Haradinaj. I pari i Qeverisë ka mohuar të ketë bërë ndonjë premtim për Asociacionin e Komunave me Shumë Serbe. "Qëndrimet për asociacionin ju i dini, vetëm çfarë thotë Kushtetuta e vendit. Këtë qëndrim e kam pasur si me palët e brendshme, me të jashtme dhe me qytetarët serbë të Kosovës. Jam jashtëzakonisht i respektueshëm ndaj serbëve të Kosovës. Ata i kam informuar për të gjitha temat, sado të ndjeshme qofshin ato. Por nuk kemi një marrëdhënie të tillë çfarë e ka lajmëruar presidenti", ka thënë Haradinaj. Po ashtu, kryeministri ka deklaruar se nuk i ka premtuar nënkryetarit të Listës Serbe, Millan Radojçiq, postin e kryetarit të asociacionit. "Thaçi takohet me njerëz si ai edhe në Prishtinë, edhe në Bruksel. Ata janë të njëjtit. Kam shumë respekt për zotin Radojçiq, për zotin Rakiq, Sllavko Simiq, Igorin, për të gjithë. Pra, premtime të tilla nuk kanë ndodhur", është shprehur Haradinaj. Ai ka thënë se nuk ka asgjë me presidentin e vendit. Sipas Haradinajt, mospajtimet me të lidhen me temat. "Unë nuk e kam me të (Thaçin). E kam me temat. Ju e dini se çka kemi hequr si Kosovë për ta korrigjuar një marrëveshje të kufirit me Malin e Zi. Pra, nuk po korrigjojmë kufi me Malin e Zi, por marrëveshje të gabuar. Nuk do të lejoj të përsëritet historia, që të luajmë me kufi dhe territore të këtij

Miratohet raporti për Kosovën, Sholtes përmend shansin e madh për vizat

Komiteti i Punëve të Jashtme të Parlamentit Evropian ka dhënë dritën jeshile në Raportin e Progresit të Kosovës për vitin 2018

PRISHTINË, 9 TETOR (ER) - Të martën Komiteti i Punëve të Jashtme të Parlamentit Evropian (AFET) ka votuar Raportin e Progresit të Kosovës për vitin 2018. Ky raport është aprovuar me 42 vota për, 10 kundër dhe 6 abstenime. Raportuesi i Parlamentit Evropian për Kosovën, Igor Sholtes, është

shprehur i kënaqur me rezultatin e votimit. "Kosova aktualisht është në pikën më të afërt që më në fund ta marrë regjimin pa viza të dhënë nga Bashkimi Evropian, i cili do t'i jepte Kosovës mundësinë për të shkuar drejt një shoqërie moderne me shpejtësinë e saj të plotë. Për të arritur këtë, nevojitet një

luftë e vazhdueshme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Gjithashtu, të gjitha përpjekjet duhet të vihen në krijimin e një mjedisi të shëndetshëm biznesi, forcimin e një gjyqësori të pavarur dhe arritjen e një institucioni funksional të zbatimit të ligjit", ka deklaruar Sholtes.



Flet për "Epokën e re", Blerim Kuçi

Nuk u fiksohemi kërcënime



Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Blerim Kuçi, ka bërë me dije se koalicioni qeverisës është duke funksionuar siç duhet dhe partnerët e tij kanë raporte të mira. Ai ka thënë se nuk u frikësohen kërcënimeve të presidentit Thaçi për rrëzimin e Qeverisë dhe për zgjedhje të reja. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Kuçi ka deklaruar se deklaratat e tilla më tepër kanë për qëllim faktorizimin e Thaçit në këto procese. Sipas tij, presidenti Thaçi nuk duhet të bëhet xheloz me sukseset e Qeverisë Haradinaj meqë ato janë edhe suksese të Kosovës. Pavarësisht prej kundërshtimeve, Kuçi ka treguar se Qeveria e mbështet vazhdimin e procesit të dialogut por, sipas tij, Kuvendi duhet të ketë rol kyç nëpërmjet mekanizmave monitorues

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 9 TETOR - Deputeti i Kuvendit të Kosovës dhe nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Blerim Kuçi, ka thënë të martën se kundërshtimet nga distanca në mes të kryeministrit Ramush Haradinaj dhe presidentit Hashim Thaçi nuk e vënë në pikëpyetje funksionimin e mëtutjeshëm të koalicionit qeverisës.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka vlerësuar se kërcënimet për rrëzimin e Qeverisë kanë për qëllim faktorizimin e presidentit Thaçi. "Deklaratat e tilla kanë për qëllim faktorizimin e presidentit Thaçi në këto procese. Intenca për t'u faktorizuar edhe jashtë kompetencave të veta është normale, mirëpo unë do ta këshilloja presidentin Thaçi që të mos bëhet shumë xheloz me sukseset e Qeverisë Haradinaj, sepse suk-

seset e saj janë edhe të Kosovës", është shprehur Kuçi. Pavarësisht prej kundërshtimeve, ai ka treguar se Qeveria e mbështet vazhdimin e procesit të dialogut por, sipas Kuçit, Kuvendi duhet të ketë rol kyç përmes mekanizmave monitorues. Ai ka bërë thirrje për konsensus në dialog, duke thënë se në këtë drejtim partitë opozitare duhet të jenë më bashkëpunuese, dhe jo të sillen konform interesave të ngushta partiake. "Në këtë drejtim presi-

denti Thaçi duhet të kërkojë konsensus dhe të punojë në këtë drejtim. Ai duhet të jetë person unifikues por, për fat të keq, ai po e luan rolin e kundërt. Kryeministri është duke punuar fuqishëm në këtë drejtim dhe pres që edhe partitë opozitare të jenë shumë më bashkëpunuese në këtë çështje, dhe jo të sillen konform interesave të ngushta partiake", ka theksuar ai. Sipas Kuçit, deri në fund të vitit do të finalizohet procesi i themelimit të ushtrisë, anëtarësimit në Interpol dhe liberalizimit i vizave. Madje ai ka paralajmëruar dorëheqje nga pozita e deputetit në rast se nuk u hiqen vizat qytetarëve të Kosovës. "Si deputet i Kuvendit të Kosovës kam bërë me dije se nëse nuk ndodh liberalizimi i vizave brenda këtij viti do të jap dorëheqje nga kjo pozitë. Në një afat të shkurtër kohor do të kemi ushtrinë, liberalizimin si dhe anëtarësimin në Interpol", ka deklaruar Kuçi.

"Epoka e re": Z. Kuçi, kundërshtimet nga distanca në mes të kryeministrit Haradinaj dhe presidentit Thaçi e vënë në pikëpyetje funksionimin e mëtutjeshëm të koalicionit qeverisës?

Kuçi: Jo, nuk e vënë. Z. Thaçi është një lojtar politik dhe dëshiron të jetë aktiv për temat që janë të rëndësishme për Kosovën. Ai po i bën këto deklaratime me qëllim që ne dhe i gjithë opinioni të merret me të. Institucioni i presidentit ka rol unifikues dhe ai ka për detyrë që ta luajë këtë rol pozitiv dhe me opozitën. Duke pasur parasysh natyrën e tij, atëherë duhet të mësohemi me të derisa të jetë president. Ai nuk mund të jetë i qetë asnjëherë, sepse dëshiron të tregojë se nuk është vetëm president, por mund të ndikojë edhe në partitë politike. Sa i përket koalicionit, do të mbijetojë në këtë formë, sepse ka të bëjë me sukseset e kryeministrit Haradinaj, sidomos me

ave për rrëzimin e Qeverisë



rehatshëm. Mënyra si godet majtas e djathtas tregon se është pak xheloz me sukseset e kësaj Qeverie.

"Epoka e re": Pavarësisht prej kësaj, Qeveria do të vazhdojë ta mbështesë dialogun e drejtuar nga presidenti Thaçi?

Kuçi: Ne e mbështesim vazhdimin e procesit të dialogut, por Kuvendi duhet të ketë rol kyç duke krijuar mekanizma monitorues për këtë proces. Qeveria i ka dhënë disa propozime dhe kemi për detyrë t'i krijojmë këta mekanizma. Është shumë me rëndësi që Kuvendi t'i krijojë këta mekanizma dhe të harmonizohet me Qeverinë në mënyrë që të ecet më tutje. Procesi i dialogut nuk do të jetë i shkurtër dhe epilogu i tij mund të jetë më i gjatë sesa vetë mandati i presidentit Thaçi.

"Epoka e re": Prisni mbështetje nga partitë opozitare për draftrezolutën e hartuar nga partnerët e koalicionit qeverisës?

Kuçi: Opozita është në një lloj mjegullie për marrjen e vendimeve. Opozita po e ka vështirë të pranojë çfarëdo propozimi që është në të mirë të Kosovës meqë nuk është propozimi i saj. Ne nuk e kemi problem nëse një propozim e jep opozita apo pozita meqë është me rëndësi që shteti të ecë përpara në këtë proces. Është e rëndësishme që ta kemi delegacionin dhe mekanizmat monitorues për këtë proces, sepse atëherë roli i një personi siç është presidenti Thaçi do të jetë minor. Në qoftë se vonohemi dhe nëse opozita vazhdon të kundërshtojë atëherë ajo po shkon paralelisht me interesat e Thaçit. Çuditërisht këto gjëra nuk po ndodhin rastësisht, me vetëdije apo pa vetëdije janë të pajtuar në këtë pjesë. Thaçi nuk dëshiron t'i ketë mekanizmat monitorues të dialogut edhe opozita në mënyrë siç po vepron ose po e shtynë këtë proces ose nuk dëshiron të bëhen këta mekanizma. Ne nuk jemi kundër që Thaçi të mos ketë rol në procesin e dialogut sepse është president i vendit, por ai duhet t'i dijë kompetencat e veta kushtetuese. Ne nuk mund t'ia marrim komplet rolin e tij në këtë proces, por vërejtjet tona janë për ndërhyrjet e tij në çështjet kushtetuese siç ishte kërcënimi i fundit se do ta çojë vendin në zgjedhje. Në atë formë nuk mund të shkohet në zgjedhje.

"Epoka e re": I frikësoheni kërcënimit të presidentit Thaçi për rrëzimin e Qeverisë nëse kryeministri nuk i korrigjon deklaratat për dialogun?

Kuçi: Partnerët e koalicionit qeverisës kanë raporte të mira

dhe koalicioni po funksionon siç duhet. Nuk i frikësohemi as rrëzimit të Qeverisë e as shkuarjes në zgjedhje. Ne kemi frikë se kjo mos ka të bëjë me ndaljen e procesit të krijimit të ushtrisë, liberalizimit të vizave dhe anëtarësimit të Kosovës në Interpol. Kurse sa iu përket zgjedhjeve, çdoherë jemi gati dhe nuk kemi asnjë lloj problemi. Mirëpo nuk besoj se ka vullnet për zgjedhje të reja duke pasur parasysh procesin e dialogut të cilin e kemi përpara. Besoj se edhe opozita, së paku një pjesë e saj, është e arsyeshëm në këtë kuptim, por as faktori ndërkombëtar nuk do të lejojë të dështojë ky proces. Sidoqoftë, AAK-ja është e gatshme për zgjedhje kurdo që ato mbahen.

"Epoka e re": Thaçi nuk mund ta rrëzojë kryeministrin Haradinaj?

Kuçi: Jo. Deklaratat e tilla kanë për qëllim faktorizimin e presidentit Thaçi në këto procese. Intenca për t'u faktorizuar edhe jashtë kompetencave të veta është normale, mirëpo unë do ta këshilloja presidentin Thaçi që të mos bëhet shumë xheloz me sukseset e Qeverisë Haradinaj sepse

sukseset e saj janë edhe të Kosovës.

"Epoka e re": Edhe opozita ka paralajmëruar mobilizim për rrëzimin e Qeverisë. Ndihet i rrezikuar koalicioni qeverisës nga kjo opozitë?

Kuçi: Që nga krijimi i kësaj Qeverie opozita ka pasur për qëllim rrëzimin e saj. Ka kaluar një vit, do të kalojnë edhe dy, tri e katër vjet të tjera. Natyrisht se opozita në vazhdimësi ka për synim rrëzimin e Qeverisë, prandaj në këtë drejtim sjellja e opozitës është normale. Mirëpo nuk është normale në raport me procesin e dialogut sepse ky proces është më shumë sesa votuesit, zgjedhjet dhe interesat e një partie.

"Epoka e re": Mund të arrihet konsensusi për procesin e dialogut?

Kuçi: Në këtë drejtim presidenti Thaçi duhet të kërkojë konsensus dhe të punojë në këtë drejtim. Ai duhet të jetë person unifikues por, për fat të keq, ai po e luan rolin e kundërt. Kryeministri është duke punuar fuqishëm në

këtë drejtim dhe pres që edhe partitë opozitare të jenë shumë më bashkëpunuese në këtë çështje, e jo të sillen konform interesave të ngushta partiake.

"Epoka e re": Ju deri më tani po i konsideroni suksese çështjen e ushtrisë, liberalizimit dhe anëtarësimin në Interpol. Mund të presim finalizim të këtyre proceseve deri në fund të vitit?

Kuçi: Si deputet i Kuvendit të Kosovës kam bërë me dije se nëse nuk ndodh liberalizimi i vizave brenda këtij viti do të jap dorëheqje nga kjo pozitë, sepse është e pakuptimit të mos ndodhë liberalizimi këtë vit. Do të ishte një e padrejtë e madhe që u bëhet qytetarëve të Kosovës. Prandaj nëse nuk ndodh një gjë e tillë, në shenjë rebelimi ndaj vendimit të BE-së, do të jap dorëheqje. Liberalizimin e vizave e kanë fituar të gjitha vendet e rajonit, po ashtu pjesë e BE-së janë edhe shumë shtete të cilat në asnjë aspekt nuk janë përpara Kosovës. Në një afat të shkurtër kohor do ta kemi ushtrinë, liberalizimin si dhe anëtarësimin në Interpol.

Thaçit i kërkohet ta kthejë procesin e listave të veteranëve në pikën zero

PRISHTINE, 9 TETOR (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, është takuar të martën me përfaqësuesit e Organizatës së Veteranëve të Luftës së ish-Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hysni Gucatin dhe Migjen Shalën. Nëpërmjet një postimi

në llogarinë e vet në "Facebook", Thaçi ka njoftuar se përfaqësuesit e OVL-së së UÇK-së kanë kërkuar nga ai që i tërë procesi i listës së veteranëve të kthehet në pikën zero. "Përfaqësuesit shprehën shqetësimet e tyre lidhur me

listat e veteranëve të UÇK-së dhe kërkuan që ta ushtroj autoritetin tim, që i tërë procesi të kthehet në pikën zero, duke e konsideruar këtë si të vetmen mundësi për tejkalimin e parregullsive të shumta", ka shkruar Thaçi.



çështjen e ushtrisë, liberalizimit të vizave, Interpolit, si dhe lehtësira që është duke u dhënë bizneseve e prodhueseve. Mbase këto edhe mund t'i pengojnë dikujt dhe mund të bëhet xheloz. Politika është e tillë dhe z. Thaçi nuk duhet të jetë xheloz për sukseset e Qeverisë.

"Epoka e re": Këto kundërshtime po bëhen për shkak të idesë për korrigjimin e kufirit, për të cilën presidenti insiston të realizohet, kurse kryeministri është kategorikisht kundër.

Kuçi: Kjo është natyra e z. Thaçi. Ju kujtohet Deklarata e Pavarësisë e cila nuk u lexua as nga presidenti Sejdiu e as nga kryeparlamentari Krasniqi, por nga kryeministri Thaçi. Pra, qëllimi i Thaçit është të jetë faktor mbi të gjithë të tjerët në secilën çështje të rëndësishme për Kosovën. Edhe ndaj ushtrisë, liberalizimit të vizave dhe Interpolit, pra nuk mund të jetë i

Tahiri: Pavarësia, llogaridhënia dhe efikasiteti, segmente të fytyrës së re të drejtësisë

PRISHTINË, 9 TETOR (ER) - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka bërë me dije se ndër çështjet e para për të cilat 'Drejtësia 2020' do të angazhohet është përfundimi i rasteve të shumta gjyqësore që për vite të tëra mbajnë peng realizimin e drejtësisë për qytetarët tanë. Ai ka thënë se në funksion të kësaj, krahas masave të tjera të rritjes së përgjegjësisë së menaxhimit të kalendarit të shqyrtimeve gjyqësore, po punohet edhe në

metodat alternative të zgjidhjes së kontesteve.

Tahiri ka deklaruar se barazia, neutraliteti, pavarësia, llogaridhënia dhe efikasiteti janë segmentet e fytyrës së re të sistemit që duan dhe për të cilin do të angazhohen institucionet vazhdimisht. "Pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Ndërmjetësimin, në ditët në vijim do të rrisim kapacitetet dhe numrin e ndërmjetësuesve të cilët janë agjentë të rëndësishëm që do të

mundësojnë zgjidhje të shpejtë, efikase dhe me kosto të ulët të mosmarrëveshjeve. Me ligjin e ri kemi plotësuar direktivën e Bashkimit Evropian duke bërë ndërmjetësimin, një masë obligative për disa lloje të çështjeve për të cilat qytetarët rëndomë kanë pritur me vite në procese gjyqësore. Ndërmjetësuesit do të jenë pjesë integrale e sistemit të drejtësisë dhe do të shërbejnë si shtyllë e rëndësishme në përkushtimin



Çekia ofron përkrahje për anëtarësimin e Kosovës në Interpol dhe UNESCO



Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka takuar në Pragë kryetarin e Senatit të Çekisë, Milan Stech, me të cilin ka biseduar për anëtarësimin e Kosovës në Interpol dhe UNESCO

PRAGË, 9 TETOR (ER) - Republika e Çekisë e përkrah liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës dhe agjendën e integritimit evropian të vendit tonë. Ky qëndrim u shpreh në takimin që kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, pati të martën në

Pragë me kryetarin e Senatit të Çekisë, Milan Stech. Gjithashtu, Çekia ka ofruar mbështetjen për anëtarësimin e Kosovës në Interpol dhe UNESCO.

Kryetari Veseli ka falënderuar homologun e tij për mbështetjen që Çekia i ka dhënë Kosovës

për vite me radhë në procesin e shtetndërtimit, por edhe tani në proceset

integruese. Kryeparlamentari Veseli ka theksuar se qytetarët e Kosovës presin me të drejtë, pasi janë plotësuar edhe kriteret e nevojshme, që brenda vitit të hiqen vizat për Zonën Shengen. Ai ka folur edhe për fazën finale të dialogut me Serbinë, ku theksoi përkushtimin e Kosovës për një marrëveshje që do të hapte perspektivë për të dyja vendet.

Në këtë takim u bisedua për

raportet në mes të Kosovës dhe Çekisë dhe për mundësitë e bashkëpunimit, në veçanti në mes të dy parlamenteve, por edhe në fushën e ekonomisë. Kryetari Veseli ka thënë se Kosova ka potencial të jashtëzakonshëm për investime në shumë sektorë. Me këtë rast, ai ftoi homologun e vet çek që t'i inkurajojë investitorët nga vendi i tij të investojnë në Kosovë.

Ndërsa kryetari i Senatit të Çekisë, Milan Stech, shprehu përkrahjen për agjendën evropi-

ane të Kosovës, në veçanti për liberalizimin e vizave. Po ashtu, ai ka shprehur gatishmërinë për bashkëpunim midis parlamenteve, në mënyrë që të thellohen raportet në mes të dy vendeve tona.

Gjatë vizitës së tij në Çeki, kryetari Veseli ka marrë pjesë edhe në Forum 2000, në të cilin ishin pjesëmarrës personalitete të ndryshme nga shumë vende të botës. Ky forum u themelua para rreth 20 vjetëve nga ish-presidenti çek Vaclav Havel.

Ismaili: Shumë shpejt do të vijë kontingjenti i parë me shtretër të rinj

PRISHTINË, 9 TETOR (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka paralajmëruar se së shpejti do të vijë edhe kontingjenti i parë me qindra shtretër të pajisur me dyshekë të denjë që do të vendosen nëpër klinika. "Disa nga këta shtretër të cilët po i shihni në këto fotografi në QKUK janë

nga viti 1983. Fatkeqësisht, për vite me radhë qytetarët tanë janë ballafaquar me këso lloj kushtesh nëpër disa klinika. Por, ashtu siç po u vjen fundi shumë parregullsive të tjera, edhe gjendjen me shtretër do ta rregullojmë. Shpejt do të vijë edhe kontingjenti i parë me qindra

shtretër të pajisur me dyshekë të denjë, për qëndrim të qytetarëve tanë. E dimë se kemi ende sfida, por një nga një do t'i trajtojmë për një sistem shëndetësor cilësor me qendër qytetarin", ka shkruar ministri Ismaili në llogarinë e vet në "Facebook".





Qeveria e Kosovës ka mbajtur mbledhjen e radhës

Qeveria merr vendim për kompensimin e punës jashtë orarit për Policinë

Qeveria e Kosovës ka miratuar vendimin për kompensimin e punës jashtë orarit për Policinë e Kosovës. Shuma e ndarë është 2 milionë e 600 mijë euro dhe është bërë me qëllim të ruajtjes së performancës, efikasitetit dhe efektivitetit për arritjen e objektivave kushtetuese dhe ligjore të Policisë së Kosovës

EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 9 TETOR - Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar kërkesën për ndarjen e mjeteve financiare për Policinë e Kosovës, me qëllim të kompensimit të pagesave shtesë për zyrtarët policorë për punën e angazhimit jashtë orarit gjatë këtij viti. Shuma e ndarë është 2 milionë e 600 mijë euro dhe është bërë me qëllim të ruajtjes së performancës, efikasitetit dhe efektivitetit për arritjen e objektivave kushtetuese dhe ligjore të

Policisë së Kosovës. Kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se ndihet mirë që ka arritur këtë çështje mjaft të përfolur për Policinë e Kosovës. "Është e dhimbshme për Policinë e Kosovës, ani pse nuk ka ligj për sigurime shëndetësore dhe të drejta të tjera, merreni me mend, u është kërkuar të bëjnë punë shtesë, por nuk u është paguar. Nga sot është zero me zero llogaria. Nuk i kemi borxh njëri-tjetrit, as shteti policisë e as policia shtetit. Më vjen mirë që taksapaguesi i Kosovës është nderuar para policëve.

Shpresoj se Policia e Kosovës e kupton që i ka borxh t'i shpërblejë me nder taksapaguesit e vet", ka thënë Haradinaj. Po në këtë mbledhje kabineti qeveritar ka miratuar Projektligjin për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike. Me plotësimin dhe ndryshimin e ligjit parashihet që të sqarohen disa prej dispozitave ligjore, me theks të veçantë te kontrolli i financimit të subjekteve politike, auditimit të raporteve financiare dhe publikimit të tyre. Gjithashtu, me projektligj përcaktohen edhe masat ndëshkuese për subjektet që nuk respektojnë kërkesat e dala nga ky ligj. Kryeministri Haradinaj, në prezantimin e projektligjit, ka bërë me dije se për plotësimin e tij janë marrë edhe mendimet e Komisionit të Venedikut për të cilin ka thënë se kanë

bashkëpunim të mirë. "Është themeluar komisionin përkatës për hartimin e projektligjit. Komisioni ka marrë për bazë edhe mendimet e Komisionit të Venedikut", është shprehur ai. Në këtë mbledhje Qeveria ka miratuar vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Programit legjislativ të vitit 2018 të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Në Programin legjislativ të vitit 2018 të Qeverisë së Republikës së Kosovës do të përfshihen: Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë dhe GIZ-it (Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar) për bashkëfinancimin e projektit Cetap, Projektligji për tregti të brendshme dhe Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e

Ligjit për letërnjoftimin. Në mbledhjen e së martës është aprovuar Projektligji për produktet biocide, i cili rregullon funksionimin e tregut të brendshëm dhe bën harmonizimin e rregullave për vënien në treg dhe përdorim të produkteve biocide, me qëllim të sigurimit të shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe mjedisit. Gjithashtu, miratimin nga kabineti qeveritar e ka marrë edhe Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe GIZ-it (Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar) për bashkëfinancimin e projektit CETAP (Krijimin e punësimit përmes promovimit të eksportit). Qeveria e Kosovës ka miratuar vendimin për ndarjen e buxhetit shtesë prej 650 mijë eurove për Zyrën për Çështje të Komuniteteve.


Një muaj paraburgim për të dyshuarin nga Kosova që shkoi në Siri

PRISHTINË, 9 TETOR (ER) - Gjykata Themelore e Prishtinës i ka caktuar një muaj paraburgim të pandehurit M. D., i cili dyshohet se në vitin 2013 kishte shkuar në Siri dhe i ishte bashkuar organizatave terroriste. Njëpërmjet një njoftimi për media kjo gjykatë ka bërë me dije se ka miratuar kërkesën e

Prokurorisë Themelore në Prishtinë, për caktimin e kësaj mase kundër të pandehurit M. D. "Të pandehurit M. D. i është caktuar masa e paraburgimit në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji. Ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri M. D. që nga muaji mars të vitit 2013 kishte shkuar

nga Gjermania përmes rrugëve të ndryshme në Republikën arabe të Sirisë dhe u është bashkuar organizatave të ndryshme, organizata këto të shpallura terroriste nga ana e Kombeve të Bashkuara", është thënë në njoftimin për media. Sipas Gjykatës Themelore të

Prishtinës, masa e paraburgimit kundër të pandehurit M. D. "është masë adekuate dhe se pala ka të drejtë ankese kundër këtij vendimi". Në raportin e fundit të Departamentit amerikan të Shtetit për terrorizmin në botë për vitin 2017 është thënë se rreth 200 qytetarë të Kosovës vazhdojnë të



jenë në zonat e konfliktit në Siri dhe Irak, duke përfshirë edhe shumë fëmijë të lindur atje.

I jepet lamtumira e fundit gazetarit Ibrahim Rexhepi

Jeta dhe vepra e Ibrahim Rexhepit, si profesionist i fushës së gazetarisë, u vlerësua lart nga ish-kolegët dhe bashkëpunëtorët me të cilët ai ka punuar për vite të tëra

PRISHTINË, 9 TETOR (ER) - Ish-gazetarit të ekonomisë, Ibrahim Rexhepit, të martën iu dha lamtumira e fundit, në varrezat e fshatit të tij të lindjes, Slivovë të Ferizajt. Në ceremoninë e varrimit morën pjesë familjarë, miq, të afërm, kolegë dhe përfaqësues të institucioneve. Kurse Aleanca Kosova e Re (AKR) dhe Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AKR) të martën kanë mbajtur mbledhje përkujtimore për ish-gazetarin, Ibrahim Rexhepi.

Jeta dhe vepra e Ibrahim Rexhepit, si profesionist i fushës së gazetarisë, u vlerësua lart nga ish-kolegët dhe bashkëpunëtorët me të cilët ai ka punuar për vite të tëra. Ibrahim Rexhepi rrugëtimin në profesionin e gazetarisë e kishte nisur që në vitin 1976 në të përditshmen "Rilindja", ku punoi deri në ndalimin e saj, pastaj e vazhdoi në shumë media të tjera. Vesel Makolli, përfaqësues i AKR-së dhe zëvendësministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale, në emrin e liderit të kësaj partie u ka shprehur ngushëllime familjes Rexhepi për ndarjen nga jeta të më të dashurit të tyre. "E kam të vështirë ta bind veten dhe juve që më nuk është në mesin tonë familjari, miku dhe bashkëpartaku ynë që na la në kujtim shumë vepra që do ta kujtojmë me krenari sa të jemi gjallë", ka deklaruar Makolli.

Në emër të familjes Rexhepi ka folur Skënder Rexhepi, i cili ka

thënë se Ibrahim ishte i të gjithëve dhe, si i tillë, ai ishte njeri i madh.

Gazetarja e ekonomisë në gazetën "Epoka e re", Albulena Mavraj, në emër të gazetarëve ka shprehur ngushëllime për vdekjen e Ibrahim Rexhepit. Ajo ka thënë se Ibrahim Rexhepi ishte shembull i gazetarit të ekonomisë i cili e njihte shumë mirë këtë sektor. "Me Ibrën fillova karrierën time, edhe pse punoja në një medium tjetër. Ibra gjithnjë na ofronte këshilla. Ai dinte të na kritikonte aq zëulur dhe të na bënte të pendohemi në mënyrë që të mos i përsërisim gabimet në shkrime", ka deklaruar gazetarja Mavraj.

Edhe ish-kolegia dhe bashkëpunëtorja në gazetën "Rilindja", Evliana Berani, e ka kujtuar Rexhepin si një profesionist të pasqorë të çështjeve ekonomike. Berani, ndër të tjera, ka thënë se nga Ibrahim Rexhepi si kolegë, si mik dhe si mentor ka mësuar aspektin praktik të rendit të ri demokratik, tregun e lirë dhe konkurrencën si dhe shumë aspekte të tjera të fushës ekonomike.

Kryetari i Unionit të Gazetarëve Shqiptarë, Aleksandër Çipa, ka thënë se Rexhepi do të mbesë në kujtesën e komunitetit të gazetarëve të hapësirës shqiptare si një ndër gazetarët më të mirë të profilit ekonomik. Ndërkaq kryetarja e Asociacionit të



Gazetarëve të Kosovës, Gentiana Begolli-Pustina, ka thënë se për vite të tëra Ibrahim Rexhepi ka qenë pjesë e pandashme edhe e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, në veçanti në vlerësimet e storieve profesionale nga fusha e

ekonomisë.

Ajo e ka vlerësuar Rexhepin si një njeri madhështor dhe profesionist. "Nuk kam besuar se fjalimin tim të parë si përfaqësuese e gazetarëve të Kosovës do ta filloj me një fjalim mortar. Aq ma pak dedikuar një

njeriu që tërë jetën ia kushtoi gazetarisë dhe të vërtetës. Një gazetar i eksperi të respektuar nga të gjithë. Një njeriu që nuk ka kush ta zëvendësojë në komunitetin tonë, sepse Ibrahim ka qenë një", ka thënë Begolli-Pustina.

Reçica takoi përfaqësuesit e Bankës Botërore, flasin për reformat në fushën sociale

PRISHTINË, 9 TETOR (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Skender Reçica, ka pritur të martën në takim përfaqësuesit e Bankës Botërore, me të cilët ka diskutuar rreth ecurisë së reformave të ndërmarra nga MPMS-ja me theks të veçantë

në fushën sociale. Gjatë këtij takimi është diskutuar rreth draftit të parë të raportit të Bankës Botërore sa i përket rishikimit të Skemës së Ndhmës Sociale.

Me këtë rast ministri Reçica ka falënderuar përfaqësuesit e Bankës Botërore për ndihmën

që po i japin MPMS-së jo vetëm sa i përket reformës sociale, por edhe reformave të tjera të ndërmarra. Kurse Stephanie Brodmann, përfaqësuese e Bankës Botërore, ka thënë se mbështetja e tyre për iniciativat e MPMS-së do të vazhdojë edhe më tutje.



Njazi Thaqi: KEK-u, adresë e ngritjes profesionale për kuadrot e reja

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 9 TETOR - Ushtruesi i detyrës së drejtorit menaxhues në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK), Njazi Thaqi, ka thënë se KEK-u është bërë një adresë e duhur që ofron mundësi për ngritjen profesionale dhe praktike të kuadrove të reja, duke rritur kapacitetet edhe në Qendrën e Trajnimeve, në disa lëmenj për të cilat aktualisht, por edhe gjithëherë, do të ketë nevojë tregu i punës.

Këtë deklaratë Thaqi e ka dhënë para studentëve të certifikuar në programin e Repower Kosovo "Ngritja e kapaciteteve të studentëve në sektorin energjetik të Kosovës". "Çdo herë është kënaqësi të shohim gjenerata të reja që arsimohen mirë, diplomojnë dhe kualifikohen si profesionistë për tregun e punës. Kjo gjithmonë është dhe do të mbetet perspektiva dhe e ardhmja e një gjenerate të re, e ardhmja e një shteti që synon të ketë progres, rritje ekonomike dhe zhvillim", ka thënë ai.

Thaqi ka thënë se për të është kënaqësi që është këtu për ta përfaqësuar Korporatën

Energjetike të Kosovës, ku për gjashtë muaj studentët kanë avancuar shkathësitë e tyre praktike. "Keni pasur mundësinë t'i merrni mësimet e para duke qenë drejtpërdrejt në kontakt me makineritë dhe teknologjinë e KEK-ut. Pra, në TCA, TCB dhe Miniera, ku ju keni ndjekur punën praktike dhe keni mësuar procesin prej ku eksplorohet thëngjilli e deri te prodhimi i energjisë elektrike. KEK-u tashmë është bërë një adresë e duhur që po ofron këtë mundësi në ngritjen profesionale dhe praktike të kuadrove të reja, duke rritur kapacitetet edhe në Qendrën e Trajnimeve, në disa lëmenj për të cilat aktualisht, por edhe gjithëherë, do të ketë nevojë tregu i punës. Jemi duke punuar shumë në këtë drejtim", është shprehur ushtruesi i detyrës së drejtorit menaxhues në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK), Njazi Thaqi. Ai ka theksuar se mbetet thellësisht i përkushtuar që të mbështesë iniciativën tilla për ngritje profesionale për t'i batur njohuritë te brezi i ri.

Thaqi ka pohuar se do t'ju jetë mirënjohës donatorëve që po përkrahin në ngritjen e



kapaciteteve profesionale në KEK. "Një falënderim të veçantë për mbështetjen e vazhdueshme të USAID-it e, po

ashtu, edhe Repower Kosovo për realizimin e projektit 'Ngritja e kapaciteteve të studentëve në sektorin energjetik

të Kosovës'. Mirënjohje për punën e shkëlqyeshme të AUK-ut dhe Universitetit të Prishtinës", ka thënë Thaqi.

Ministri Shala funksionalizon objektet e MTI-së



PRISHTINË, 9 TETOR (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka marrë vendimin e dytë të rëndësishëm që nga fillimi i punës së tij javën e kaluar. Shala ka vendosur fillimisht Agjencinë e Metrologjisë, që është në kuadër të MTI-së, ta dislokojë në objektin e kësaj ministrie në Bërnice të Prishtinës, më pas edhe dy agjenci të tjera, atë të

Standardizimit dhe Akreditimit. Ai ka thënë se me këtë do të ketë një qendër moderne të cilësisë të Republikës së Kosovës.

Shala e ka vizituar objektin e kësaj ministrie në Bërnice të Prishtinës bashkë me ekipin e këshilltarëve dhe kryeshefat e Agjencive të Metrologjisë, Standardizimit dhe Akreditimit. Ministri Shala ka theksuar se do të marrë vendim menjëherë që këto tri agjenci të dislokohen në

këtë objekt, duke shtuar se gjendja e tij nuk do të vazhdojë më kështu. "Qeveria e Kosovës ka investuar afër 2 milionë euro dhe, fatkeqësisht, ka mbetur në këtë gjendje jo të mirë. Për shkak të moskujdesit ka ardhur duke u dëmtuar çdo ditë e më shumë. Unë sot do të marr vendim ta dislokoj këtu Agjencinë e Metrologjisë. Banka Botërore e ka përkrahur me një fond MTI-në që ta adaptojë dhe funksionalizo-

jë këtë objekt. Po ashtu, e kam ide ta bëj edhe dislokimin e Agjencisë së Standardizimit dhe Akreditimit në këtë objekt, dhe këtë investim të qytetarëve tonë ta bëjmë të shfrytëzueshëm", ka thënë Shala. Ministri Shala ka thënë se më nuk do të ketë kesi lëshimesh që të mbeten investimet në mëshirën e fatit. "Jam shumë i vendosur t'i çoj përpara proceset dhe mos të lejojmë kesi investimesh milionëshe të mbesin në mëshirën e fatit. Kjo

nuk do të tolerohet më. Këto objekte do të menaxhohen seriozisht dhe denjësisht, si e meritojnë institucionet shtetërore të trajtohen dhe mirëmbahen", ka thënë Shala.

Ministri Shala e ka marrë detyrën javën e kaluar dhe, që në javën e parë të punës ka marrë vendim ta bëjë Kosovën me Tregues Gjeografik, që do të ndikojë në rritjen e besimit të produkteve vendore.

Bahtiri takon diplomatët austriakë, flasin për zhvillimet në Mitrovicë

MITROVICË, 9 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka pritur të martën në takim Thomas Muhlmann, udhëheqës i Departamentit për Ballkanin Perëndimor në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Austrisë dhe ambasadorin e Austrisë në Prishtinë, Gernot Pfandler, me të cilët ka biseduar për gjendjen aktuale në Komunën e Mitrovicës dhe në shtetin e Kosovës. Me këtë rast Thomas Muhlmann ka thënë se është shprehur i kënaqur që ndodhet përsëri në Mitrovicë dhe Kosovë. Ai ka theksuar se qëllimi i kësaj vizite është që të njihet më mirë me situatën e përgjithshme në Kosovë. "Austria është një shtet mik i Kosovës që ka dhënë

vazhdimisht kontribut dhe që ka mbështetur çështjen e Kosovës. Edhe unë jam shumë i interesuar për Kosovën, në veçanti për Mitrovicën, prandaj kam ardhur këtu për të mësuar më shumë nga ju për situatën e përgjithshme dhe për zhvillimet e fundit", është shprehur Muhlmann.

Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka thënë se qytetarët e Mitrovicës, edhe ata të shtetit të Kosovës, janë shumë mirënjohës për angazhimin e shtetit të Austrisë për çështjen e Kosovës dhe për mbështetjen e pakursyer që ka dhënë në të gjitha proceset e zhvillimit të deritashëm të Kosovës. Ai ka thënë se situata e përgjithshme në Mitrovicë është e qetë dhe pa probleme.



Lansohet granti i performancës së komunave

PRISHTINË, 9 TETOR - Është lansuar granti për performancën e komunave, i cili është organizuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, ku përfituese nga ky program për vitin 2019 janë 19 komuna.

Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Ivan Todosijević, ka deklaruar se përmbushja e 14 kriterëve të performancës e bën më të mirë jetën e qytetarëve. "Jemi shumë të kënaqur se në kuadër të fondit stimuloes të MAPL-së për vitin 2018 janë përzgjedhur 11 komuna përfituese të grantit prej 900 mijë eurosh dhe këtë vit, në bazë të treguesve të vitit 2016 përmes grantit të performancës dhe financimit në mes të MAPL-së dhe SDC Demos, 25 komuna

kanë marrë mjete në shumë prej 2 milionë e 25 mijë eurosh. Këtë vit kemi vlerësuar të arriturat e komunave në bazë të treguesve për vitin 2017 për ndarjen e granteve në vitin 2019 dhe janë përzgjedhur 19 komuna shfrytëzuese në vlerë prej 2 milionë e 250 mijë eurosh", ka thënë Todosijević.

Edhe Hyzer Gashi nga Ministria e Financave ka deklaruar se financimi i komunave dhe realizimi i mirëfilltë i buxheteve të tyre ndikon në jetën e qytetarëve. Ai ka thënë se kjo ministri është e përkushtuar për financimin e tyre, duke shtuar se komunat përmes këtij granti po stimulohen për një performancë më të mirë në qeverisjen lokale. "Shumë e qëlluar është fushëveprimtaria e këtij granti që përmes stimulimit financiar

tash nxisim, përkrahim komunat, përmirësojmë performancën e tyre në fushat e qeverisjes demokratike, menaxhimit e transparencës. Në fakt, pikërisht këto sfera të angazhimit janë në masë të madhe përcaktuese për zhvillimin e përgjithshëm të secilës komunë, prandaj edhe përkrahja e tyre krijon dhe do të krijojë efekte pozitive në qeverisjen lokale", ka thënë Gashi. Ai ka shtuar se në bazë të mundësive buxhetore do ta rrisin mbështetjen financiare për Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal si dhe për komunat. Kurse ambasadori zviceran Jean-Hubert Lebet ka deklaruar se menjëherë pas luftës Zvicra ka filluar ndihmën ndaj Kosovës, duke përfshirë disa lloje të ndihmave me ndikim në komuna.



Fillon ndërtimi i tri kilometrave trotuar në Drenoc të Malishevës

MALISHEVË, 9 TETOR - Në fshatin Drenoc të Komunës së Malishevës ka filluar ndërtimi i tri kilometrave trotuar në lagjet e këtij fshati, që lidhë rrugët e asfaltuara me shkollën "Xhevë Lladrovci".

Qëllimi i ndërtimit të këtij trotuari është lëvizja më e lehtë dhe më e sigurt për banorët, në veçanti për nxënësit e këtij fshati, përkatësisht të një pjese të fshatit, ku lëvizja e

nxënësve përgjatë rrugës është e pasigurt.

Punimet për ndërtimin e këtij trotuari i ka parë nga afër nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, i cili ishte i shoqëruar edhe nga drejtori i Drejtorisë së Urbanizimit, Islam Vrenezi dhe drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Milazim Morina.

Nënkryetari Berisha është ndarë i

kënaqur me punimet që janë duke u bërë për ndërtimin e këtij trotuari. "Qëllimi i ndërtimit të këtij trotuari është krijimi i sigurisë në rrugë për të gjithë banorët, në veçanti për nxënësit, si dhe është pjesë e planifikimeve komunale në kuadër të rregullimit të infrastrukturës së përgjithshme në Komunën e Malishevës", ka thënë Berisha.

Vendoset gurthemeli i Sheshit 'Hasan Prishtina' në Vushtrri

VUSHTRRI, 9 TETOR - Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, ka marrë pjesë të martën në vënien e gurthemelit të Sheshit "Hasan

Prishtina". "Sot është vënë gurthemeli i Sheshit 'Hasan Prishtina' në Vushtrri. Urime!", ka shkruar Tahiri në llogarinë e vet në "Facebook".



A po respektohen mjaftueshëm të drejtat e personave me çrregullime mendore në Kosovë?!

NGA KËSHILLI PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË NJERIUT (KMDLNJ)



Më 10 tetor është Dita Ndërkombëtare e personave me çrregullime mendore dhe e cila shënohet si ditë kur bëhet thirrje për trajtimin e këtyre personave duke respektuar dinjitetin e tyre, si një nga vlerat elementare të të drejtave të njeriut. Gjithashtu, kjo ditë është edhe një vërejtje

publike si dhe kërkesë drejtuar institucioneve përgjegjëse që të luftojnë dhe ndërmarrin masa ligjore ndaj atyre që kontribuojnë, thërrasin apo edhe vazhdojnë stigmatizimin e kësaj pjese të qytetarëve të Kosovës e cila, falë rrethanave objektive dhe subjektive edhe më tutje po marginalizohet duke ua shkelur të drejtat elementare të njeriut. KMDLNj, i përkrahur nga KFOS e bënë monitorimin e institucioneve ku mbahen të privuar nga liria në mënyrë të pavullnetshme personat me çrregullime mendore duke identifikuar problemet me të cilat përballen këto institucione, familjet e tyre dhe vet personat në mënyrë që të dalë me rekomandime në bazë të prioriteteve për përmirësimin e kushteve të trajtimit dhe mbajtjes të këtyre personave sikur edhe stafit që është përgjegjës për trajtim. Trajtimi i personave me çrregul-

lime mendore në Kosovë, jo në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare, në radhë të parë është për shkak të moszbatimit të Ligjit për Shëndetin Mendor dhe akteve tjera nënligjore se sa mungesa e trajtimit profesional i cili jo se ka kapacitete profesionale dhe materiale për trajtim në përputhje me standardet e parapara për vendet e zhvilluara mirëpo, ka mundësi t'i plotësojë standardet minimale të nevojshme dhe të pranueshme për shtet dhe shoqëri në tranzicion siç është Kosova. Stigmatizimi dhe marginalizimi i personave me çrregullime mendore në radhë të parë e ka burimin te familja (në të shumtën e rasteve), e cila nuk ka mundësi të kujdeset për një kohë të gjatë, pastaj te rrethi shoqëror i cili ka mungesë të vetëdijes për domosdoshmërinë e trajtimit të këtyre personave pa

ua cenuar dinjitetin pastaj shkak se ka shpërputhje të madhe në zbatimin e ligjit dhe për pasojë kemi raste që në një mungesë të vendimi gjyqësor (në rrethana emergjente) institucionet përkatëse, për t'i eliminuar pasojat e mundshme për qytetarë apo vet personin me çrregullime mendore, detyrohen ta pranojnë një person, pa vendim të institucionit përkatës. Aktualisht, barra kryesore për trajtimin e personave me çrregullime mendore iu takon institucioneve shëndetësore të cilat edhe vet punojnë në kushte jo të mira, ka mungesë të barnave (jo nga lista esenciale) por nga lista e barnave specifike për këtë kategori sikur që stafi përgjegjës për këtë kategori nuk stimulohet për angazhime dhe rrezikshmëri. Krahasuar me vitet e mëparshme, Kosova ka bërë përparime në trajtimin e kësaj kategorie të cilat janë të dukshme

dhe të prekshme dhe në kuadër të mundësive ekzistuese materiale, mirëpo është standardeve ndërkombëtare që zbatohen në shtete të tjera. Përmes bashkëpunimit me mekanizmat monitorues qeveritar dhe në veçanti jo-qeveritar është bërë më i lehtë identifikimi i problemeve ekzistuese me të cilat sigurohet transparenca dhe kërkohet llogaridhënia më e madhe. KMDLNj, do të vazhdojë monitorimin e këtyre institucioneve sipas parimit të partneritetit dhe bashkëpunimit duke kërkuar zbatimin e Ligjit për Shëndetin Mendor i cili garanton trajtim dinjitoz dhe jodiskriminues të personave me çrregullime mendore. Në këtë kontekst do të ketë takime me Zyre Ligjore të Ministrisë së Shëndetësisë, Këshillin Prokurorial të Kosovës, Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Zyrën e Kryeministrit.

Ahmeti: Të punojmë me fëmijët me autizëm

PRISHTINË, 9 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, të martën ka marrë pjesë në përrurimin e investimit të TIKAs dhe shtetit të Turqisë, për funksionalizimin e objektit që ka ndarë komuna për të punuar me fëmijët me autizëm. "Sot përrurim investimin e TIKAs dhe shtetit të Turqisë, për funksionalizimin e objektit që ka ndarë omuna për të punuar me fëmijët me autizëm, derisa të ndërtohet me Qendra për Autizëm dhe Sindromë Down. Autizimi nuk është sëmundje, por është një

mënyrë tjetër e zhvillimit neurologjik", ka thënë Ahmeti. Ai ka shtuar se fëmijët me autizëm janë të veçantë, për të mirë, me talente dhe aftësi të posaçme. "Fokusimi dhe thellimi i interesimit të tyre përbën potencial unik. Hapja e mundësive për këta persona, përmes programeve të ndryshme dhe integritimit në shoqëri, përbën mundësi dhe jo pengesë. Duhet të angazhohemi së bashku që t'i identifikojmë dhe të punojmë me ta në mënyrën e tyre", ka deklaruar kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti.



Komuna e Gjilanit, përfituese e tri projekteve të rëndësishme për të rinjtë



GJILAN, 9 TETOR - Komuna e Gjilanit është përfituese e tri programeve të rëndësishme zhvillimore, ku do të angazhohen një numër i konsiderueshëm i të rinjve, ka thënë të martën në një konferencë me gazetarë, Valbona Tahiri, drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik. Në kuadër të programit të parë, "Fuqizimi i sektorit privat" të

financuara nga USAID dhe SIDA, Komuna e Gjilanit ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me tri organizata implementuese të projekteve, si organizata gjermane "Help", Universitetin Amerikan në Kosovë (AUK) dhe Klubin e Prodhuesve të Kosovës, ku do të përfitojnë 270 të rinj. "Në programin për vetëpunësim të organiza-

tës gjermane 'Help' do të përfitojnë 50 të rinj, të cilët, pasi t'i kenë ndjekur trajnimet për menaxhim biznesi, do të mund të aplikojnë për grante në formë të pajisjeve, në shumën maksimale prej 3 650 eurosh", ka thënë drejtoresha Tahiri, duke shtuar se përmes këtij programi synohet krijimi i bizneseve të reja.

E rrallë

50 vjet në det, shishja plastike del në breg si e re

Një shishe plastike që ka të paktën 47 vjet në det është gjetur në bregun e një plazhi në Britaninë e Madhe, me shkrimet në ambalazh që lexohen qartë, duke rikthyer edhe një herë përpara syve tanë problemin e mbe-turinave plastike. Shishja, e gjetur nga një



roje bregdetare në një plazh në Somerset, duket si e re.

FOTO E DITES



Ushtarët e forcave ajrore indiane marshojnë gjatë paradës së Ditës së Forcave Ajrore të Indisë. /AP/

E jashtëzakonshme

Ishulli unik privat del në shitje për 3 milionë dollarë

Një pronë e veçuar në zemër të Ishujve Thimble, me pamje panoramike mah-nitëse, është vënë në shitje për tre milionë dollarë. Cut In Two Island West është një ishull privat i cili ka një vendkalim unik. Ishulli ka shtëpi të stilit viktorian dhe pamja e tij pa kufij nxjerr në pah natyrën e mrekul-lueshme të vendit. Ishulli përfshin një banesë kryesore me katër dhoma gjumi si dhe një shtëpi më të vogël.



BARSOLETA E DITËS



Një djalë kishte lënë takim me një bionde dhe, teksa po i jepte "Ferrari"-t, i thotë:
- E dashur, dua të them diçka të rëndësishme. Unë jam i martuar.
- Idiot, më trembe! Mendova se do të më thuash se "Ferrari" nuk ishte i yti.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

"ALPHA" 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
Regjia: Albert Hughes

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

"JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN"

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennessey, Jake Lacy, etj.
Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

"NIGHT SCHOOL"

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.
Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

"SIBERIA",

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.
Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

"VENOM" 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.
Regjia: Ruben Fleischer
Based on the Marvel Comics



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI
Sot jeni shumë të

ndikueshëm nga ana emocionale. Mbase ka të bëjë me lëvizjen e planetëve në shenjën tuaj.



DEMI
Keni ndërsjelle të mendimit

dhe ndjenjave sot. Nuk dini se çfarë të bëni në këtë udhëkryq të çuditshëm.



BINJAKËT
Çdo impenjim të ditës do ta

zhvilloni në qetësi të plotë. Sot gjithçka do të rrjedhë qetë dhe pa ndonjë emocion të çuditshëm.



GAFORRJA
Sot nuk do të kënaqeni me atë çka

ju ofron partneri. Do të kërkonit më shumë dhe kjo do të ndezë një debat të fjetur.



LUANI
Krenaria juaj e sëmure do të ketë

pasoja në marrëdhënien në çift. Problemet do të thellohen çdo ditë e më shumë.



IRGJËRESHA
Sot keni në mendje një projekt

të rëndësishëm që doni ta bëni realitet sa më shpejt. Do ta kërkonit ndihmën e miqve.



PESHORJA
Dita do të përshkruhet nga

kreativiteti dhe do të merreni me ato aktivitete aq të këndshme kulturore që i kishit lënë pas dore.



AKREPI
Blerjet në kohët e fundit kanë qenë

vërtet të goditura. Asnjë gjë që keni marrë nuk do të shkojë dëm po ju ka shërbyer në forma të ndryshme.



SHIGJETARI
Kjo ditë nuk ngjan fare me ditët e

rrëmuishme që keni gjatë javës. Do të shijoni çdo çast të saj sepse ju mungonte qetësia.



BRICJAPI
Dita sot do të jetë mjaft

produktive dhe do të mbyllet nga një mbrëmje e këndshme në shoqëri të mirë.



UJORI
Keni probleme në përditshmërinë

tuaj dhe kjo gjë po ju shqetëson. Edhe pse jeni një shpirt i lirë, sot dëshironi t'ju robërojë dikush.



PESHQIT
Energjia pozitive dhe miqtë

bëjnë që kjo ditë të ecë shumë mirë dhe ju vetë të jeni gjithë kohën me buzëqeshje.

PËR LETRAT E ROBIT NË DUAR TË NJERËZVE, TË ENGJËJVE DHE TË ZOTIT

Meqenëse nuk ju duhet udhëzim tjetër për poezinë e tij, udhëtimin në këtë libër, duke bashkëndjerë me poetin që prej fillimit e deri në fund, bëjeni pa ne

B. ARMAGEDONI

Shkrimtari nga Sllapuzhani, miku im Ragip Sylaj, ka lindur më 1959. Vdiq këtë vit, në vendlindje, në shtëpinë e re të ndërtuar shumë vonë, pranë familjarëve, pa mbushur 59 vjet, me laps e fleta nëpër duar, duke shkruar dhe përmirësuar dorëshkrimin e librit më të ri me poezi, të këtij që mbani në duar, të cilit unë i kam bërë vetëm korrekturë. Nuk kam qenë afër tij që ta shihja tekta bënte përmirësime në të, veçse i kam parë ndërkohë, kur të bijtë e tij ma kanë dërguar dorëshkrimin e tij të shtypur në fleta të printerit. Po të jetonte edhe më, Ragipi ditëlindjen do ta festonte më 25 nëntor të këtij viti dhe do të kënaqej, si për cilindo libër tjetër të vetin të ri që më thoshte se e pret sikur lindjen e fëmijës: Shkrimtarët, edhe unë në mesin e tyre, i presin librat kur dalin nga furra si kur t'u lindin fëmijë. Ç'gëzim!

Datën e lindjes së tij e mbaj mend sepse Ragipi, si për librin që i kam botuar vitin e kaluar, sa ishte gjallë, me titull Kam drojë për ty, për të cilin nga Ministria e Kulturës iu dha çmimi për librin më të mirë me poezi, si për të dytin botuar tash, me titull Letër engjëllit tim mbrojtës, më ka dërguar, të fotografuar, letërnjoftimin e vet, sa për t'i plotësuar dokumentet e nevojshme për autorizim të botimit të veprës së tij, të cilën kërkesë e shpreh Ministria e Kulturës e Republikës së Kosovës në çdo konkurs që shpall për botim të dorëshkrimeve të librave dhe të veprave të autorëve shqiptarë dhe të huaj.

Për t'i botuar këta dy libra Ragipin e kam zgjedhur unë sepse ishte shkrimtar i mirë, ndër më të mirët që ka Kosova, që kanë edhe Shqipëria dhe Maqedonia. Ishte shkrimtar i mirë sepse shpeshherë, nga institucione kulturore, nga ojq dhe klube letrare dhe redaksi mediumesh dhe në manifestime poetike organizuar në Kosovë ka marrë çmimin e parë për poezi, të dytin më rrallë, të tretin më duket se kurrë. Ai nuk ka shkruar sa për t'i marrë këta çmime. Ka shkruar sepse e ka ndërjet të nevojshme të shkruajë për çdo ditë, ashtu siç e kishte të nevojshme, në dy vjetët e fundit, t'i pinte ilaçet për zbutje të dhembjeve të sëmundjes së rëndë, e cila, meqë ishte shumë e vrazhdë dhe bënte me të njëfarë loje herë të jetës e herë tjetër të vdekjes, më 30 korrik e rrëzoi në tokë. Por, jehona e tij është mbi dhe. Është në mesin tonë. Është në libra. Në 17 libra poetikë, prozaikë, dramatikë, eseistikë. Në këta libra:

Hije e gjallë (poezi), Rilindja, 1986
Anatomia e fjalës (poezi), Rilindja, 1989
Obsesioni (tregime), Rilindja, 1992

Lisi i shenjtë (poezi), Fjala, 1993
Përhitja (tregime), Plejada, 1996
Mëngjes qumështor me akull (poezi), Rozafa, 2000
Humbella e fërgëllisë (tregime), Rilindja, 2001
S'kam kohë të jetoj me vdekjen (tregime), Rozafa, 2004
Eliksir (poezi), Rozafa, 2007
Estetika e misterit (ese), Elena Gjika-Dora d'Istria, 2008
Hija e shtëpisë (tregime), Rozafa, 2008
Ma jep dorën (poezi për fëmijë), Rozafa, 2010
Dy drama (drama), Rozafa, 2012
Hiri i fjalës (poezi), De Rada, Ferizaj, 2014
Harmonia estetike (ese), Parnas, 2015
Kam drojë për ty (poezi, ribotim), Armagedoni, 2016.

Letër engjëllit tim mbrojtës është i shtatëmbëdhjeti libër i tij, i cili, nën përkujdesjen e dy djemve të tij, Artit dhe Korabit, po dhe të vëllait të tij, Bujarit, po botohet pas vdekjes së autorit nga Shtëpia Botuese Armagedoni, pas rekomandimit nga Këshilli i Librit i Ministrisë së Kulturës dhe pas vendimit të ministrit Kujtim Gashi për botim të tij. Ragipi nuk e priste këtë përkrahje financiare për botimin e librit sepse ka nisur të botojë shumë herët pa i dhënë mbështetje askush. Ka qenë gjimnazist kur ka filluar të shkruajë poezi, kurse të njëjtat ka filluar t'i botojë në fund të viteve shtatëdhjetë në shtypin ditor dhe në atë periodik. Disa vjet ka punuar mësimdhënës në vendlindje dhe gazetar në Prishtinë në disa media fizike, disa të tjera zyrtar për publikime në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës. Shpeshherë më ka thënë, se për çdo ditë që vjen në Prishtinë nga Suhareka, qoftë me autobus, qoftë me ndonjë veturë të ndonjë vendësi, bashkudhëtare ka poezinë, në të cilën, më shumë se këdo tjetër, ka vizatuar vetveten me fjalë, karakterin, formimin dhe formatin e vet dhe ka zbratur dëshirat që i pati e që s'mundi t'i realizojë për shkaqe të ndryshme, kryesisht materiale.

Ragipi për të tjerët dhe të tjerët për Ragipin

Ragipi ka shkruar shumë recensione për libra të shumë autorëve, po dhe të tjerët kanë shkruar shumë recensione për librat dhe veprat e tij. Nuk ka shkruar për shkrimtarë kërkusha. Ai ka pasur shije të hollë dhe ka shkruar hollë. E ka ditur peshën dhe rëndësinë e fjalës. Ka ditur ta vlerësojë mirë veprën e mirë dhe të keqen dhe t'u bëjë vend në letërsi. Edhe çdonjëri që ka shkruar për librat e Ragipit ka vënë re kontributin e tij në letërsinë dhe gjuhën shqipe, në të cilat fusha ka sjellë të reja nga semanto dhe



leksikostilistika. Poende ka shumë çështje stili të pazbuluara në veprat e tij.

Pos që ishte shkrimtar i mirë, ai është veçuar edhe njeri i mirë, i këndshëm, i shoqërueshëm, i mbajtjes së fjalës, i përkushtuar për punë dhe për familje. Ato fjalë që i kam dëgjuar nga të tjerët për të, edhe i kam hasur në karakterin e tij gjatë ndejave që kishim në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës, në restorantin Edi 2, në Monako e në ndonjë tjetër lokal në Prishtinë. Ky portret i tij prej të njerëzishmit u bë më i dukshëm pas vdekjes së tij, kur shumë miq filluan ta kujtojnë, ta nderojnë, të bëjnë homazhe dhe të botojnë nekrologë për të në mediat fizike dhe në ato elektronike. Me një fjalë, atë lavdërim që nuk ia thoshin në sy, ia thanë pas sysh, në mënyra dhe në medime të ndryshme, dikush edhe duke i kushtuar poezi.

Thanë dhe shkruan për Ragipin shumë, nga këtu (Kosova) e gjithkund ku ka shqiptarë. Ngushëllime për vdekjen e tij dhe mirënjohje për botimin e veprës së tij më kanë ardhur edhe mua nga shumë shtete të botës nga shumë shqiptarë që e kanë njohur, që kanë lexuar veprën e tij, që kanë lexuar poezi të tij, që kanë lexuar varg të tij, që kanë lexuar fjalë dhe fjali të tij. Megjithatë, nuk janë këta që më kanë motivuar që, punën e Ragipit të lënë në fund të jetës, për botimin e veprës Letër engjëllit tim mbrojtës, ta nxjerr në dritë unë. Është një rast tjetër. Për mua, fort i ndjeshëm.

Me Ragipin pak para lamtumirës

Miqësinë fizike që kisha me Ragipin kohë më përpara, në gjashtë muajt e fundit të jetës së tij e kam vazhduar nëpërmjet Facebook-ut. I përcillnim të fala njëri-tjetrit edhe nëpërmjet të bijve të tij, që të dytë studentë, Artit dhe Korabit, të cilët vinin në Prishtinë që ta merrnin numrin e parë dhe të dytë të revistës Akademia, në të cilën Ragipi ishte prezantuar, në numrin e parë të saj me proza poetike, në numrin e dytë me poezi.

T'ju them të drejtën, derisa m'i ka dërguar për botim prozat poetike, pra për numrin e parë të revistës që kam botuar në dhjetor të vitit 2017, nuk kam qenë në dijeni se ai vuante nga sëmundja që i mori jetën. Kur po përgatisja numrin e parë të revistës, fillova, si cilindo shkrim tjetër që është botuar në të, t'i lexoj prozat e tij të shkurtër, me titullin përmbledhës Libri i letrave e me prozat poetike të tematizuara Letër poezisë, Letër muzës, Letër vetmisë,

Letër dashurisë, Letër jetës, në të cilat vërehej gjendje e rëndë shpirtërore e tij, njëfarë përgatitje për zhvendosje në botën tjetër, së cilës i besonte, pasi edhe i lutej Zotit për shpëtim, edhe engjëjve, jo pak herë, për shpërblim matanë hapësirës së padukshme.

Pra, duke parandjerë, nëpërmjet shkrimeve të tij, gjendjen fizike dhe shpirtërore të tij jo të mirë, më 17. 5. 2018 i shkruaj privatisht në Facebook: Ragip, po të njoftoj se sot MKRS-ja e ka publikuar vendimin për botim të librit. E ka përkrahur edhe librin tënd. Nëse nuk ke bërë ose nuk do të bësh ndonjë ndryshim tjetër në të, ma nis ta redaktojme, ta lekturojmë, ta faqosim dhe ta shtypim. Gjithë të mirat!

Janë të tija fjalët e pjerrëta më poshtë që më patën ardhur në Facebook po në të njëjtën ditë, disa orë më pas: Falemnderit, gjithashtu, Berat! Listen e pashë edhe në faqen zyrtare të MKRS-së. Të lutem për mirëkuptim, sepse kam me i bërë edhe disa saktësime në dorëshkrim. Kur t'i kryej, ta nisi dorëshkrimin në versionin final. Të uroj gjithë të mirat dhe suksese!

E pres t'i bëjë ato që thoshte, saktësimet, pastaj të ma dërgojë dorëshkrimin për botim. Pas kësaj bisede, as nuk më shkruan dhe as nuk i shkruaj më kurrë. Megjithatë, interesohem për shëndetin e tij. Dhe, një ditë, në fund të korrikut, takoj të birin e tij, Korabin, i cili më njofton se "babi nuk është mirë". Dy ditë më pas, në mbrëmje, më 30 korrik, më del para syve njoftimi i një medias elektronike: Vdiq shkrimtari Ragip Sylaj. Po, por, të paktën, dikujt përmbri meje i them, do të duhej të shkruhej me eufemizëm ky lajm i vonë për vdekjen e tij të parahershme.

Dhe, ashtu siç pritej, Ragipi iku, si shumë e shumë të tjerë, po jo si gjithkush, sepse e vlerësoje jetën, i donte njerëzit më shumë se sekush tjetër. Iku njeriu që, për natyrën e qetë që kishte dhe, ashtu sikurse ishte i përbërë, pa pikë urrejtje në gjuhë dhe mendje, mund ta shkruante, krahas një libri me poezi, edhe një tjetër "ungjill" për të shpërndarë dashuri ndër njerëz dhe ndër popuj! Iku Ragipi, sikurse themi për njerëzit më të dashur dhe më të mirë, vetëm fizikisht. Sa herë që dëshironi të çmalleni me të, sikurse i sugjeronte Dritëroi të shoqes, e gjeni "në ndonjë varg a ndonjë shkronjë", teksa proteston për pakënaqësitë me arritjet dhe teksa përplasat me jetën.

Me Ragipin pas lamtumirës

Ragip Sylaj, përveç librit Letër engjëllit tim mbrojtës, na ka lënë, po sikurse lihen testamentet, për lexim dhe për diskutim, gjithë ata libra që i renditëm në faqen e dytë të kësaj parathënieje. Këtë libër që po e botoj tash e quaj të përfunduar sepse, siç më ka thënë vetë ai, në të ka bërë veç pak saktësime. E kam

parë variantin e dorëshkrimit të tij dhe ju them se kam vërejtur se ka bërë përmirësime morfologjike dhe sintaksore aq sa ka pasur njohuri nga kultura e gjuhës shqipe. Megjithatë, nisjen e këtij libri s'e ka paraparë kështu si është tash. Këtu kemi bërë një plotësim. Kemi shtuar Librin e letrave të tij, pesë prozat poetike të cilat i janë botuar, sa ai ishte gjallë, në revistën për kulturë, gjuhë dhe media, Akademia, të cilën e boton e njëjta shtëpi botuese që i botoi këtë libër. Meqenëse këto proza i ka shkruar paralelisht me poezitë e këtij libri dhe enkas për revistën që përmendëm, në botim tjetër ato nuk e kanë pasur vendin. Prandaj, i morëm nga revista dhe ia bashkëngjitëm këtij libri, i cili botohet në shenjë kujtimi dhe nderimi për krijimtarinë e tij letrare.

Së këndejmi, sikurse në poezitë e këtij libri, edhe në prozat poetike të tij, siç do të vëreni gjatë leximit të tyre, është i njëjti person, me po të njëjtën vuajtje, me po të njëjtën sëmundje, me po të njëjtat lutje, me po të njëjtat llogari, me po të njëjtën kulturë mendimi dhe shkrimi. Të pesë prozat e tij duken si pesë himne për: poezinë, muzën, vetminë, dashurinë dhe për jetën, me të cilat ka bashkëjetuar dhe të cilave, kujt më shumë se tjetër, në fund të jetës ua di rëndësinë. Sot, ky libër i dhembjes së tjetërlojtë, është për ne - miqtë e tij.

Për librin Letër engjëllit tim mbrojtës

Ky libër nis me parathënie shkruar nga botuesi, vazhdon me ndarjen në cikle të librit dhe mbyllet me një shënim të shkurtër nga jetëshkrimi i gjatë i autorit.

Pëshpëritje titullohet cikli i parë i cili ka vetëm një poezi, e cila, pos titullit Rrena më e bukur... ka edhe mbititullin Në vend të hyrjes ose Preludium.

Cikli i dytë Engjëllit tim mbrojtës ka katër poezi me të njëjtin titull, Letër engjëllit tim mbrojtës, shoqëruar në fund të titullit me numra romakë (I, II, III, IV). Këto poezi janë më të gjatat në këtë libër dhe nën titujt e tyre janë dy vargje poezish nga Fatos Arapi, Michel Houellebecq, Frederik Rreshpja, Felix Luis Viera. Këngë të sizifit titullohet cikli i tretë që ka 13 poezi. Poezia e parë e këtij cikli fillon me Lutje, I dhe mbaron me Lutje, II.

Para se të bjerë muzgu është cikli i katërt dhe i fundit dhe ka 15 poezi. Libri me poezi përfundon këtu dhe nis ai me proza.

Libri i letrave është një cikël i pesë prozave poetike mjaft të bukura të cilat janë të përafërta tematikisht me stilin e poezive sepse shkruhen nga i njëjti person në çastet e fundit të dhembjes dhe të lamtumirës me njerëzit e kësaj bote. Meqenëse nuk ju duhet udhëzim tjetër për poezinë e tij, udhëtimin në këtë libër, duke bashkëndjerë me poetin që prej fillimit e deri në fund, bëjeni pa ne. Rrofshi, kujtofshi dhe nderofshi!

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

ALBANIA - JORDAN

1

BELOUZDAD - USM ALGER

1

COTTBUS - HALLESCHER

1

Kosova zhvillon stërvitjen e dytë, optimizëm për rezultat pozitiv

Më 11 tetor "Dardanët" përballen me Maltën në stadiumin "Fadil Vokrri", kurse optimizmi është i madh për rezultat pozitiv. Trajneri Bernard Challandes i ka pasur të martën në dispozicion të gjithë futbollistët në stërvitjen e dytë të përfaqësueses



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 9 TETOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll e ka zhvilluar edhe stërvitjen e dytë për ndeshjen e Ligës së Kombeve ndaj Maltës e cila zhvillohet të enjten në orën 20:45. Trajneri zviceran i Kosovës, Bernard Challandes, ndryshe nga stërvitja e parë, të martën i kishte në dispozicion të gjithë futbollistët, përfshirë edhe yllin e Lazios, Valon Berisha, i cili rikthehet në përfaqësuese pas një kohe të gjatë.

Kapiteni i Kosovës, Samir Ujkani, ka shfaqur optimizëm për rezultat pozitiv në ndeshjen që zhvillohet në stadiumin "Fadil Vokrri". "Ne do të vazhdojmë të punojmë edhe më shumë dhe me ritëm më të lartë duke marrë parasysh se kemi vetë tri ditë para ndeshjes kundër Maltës. Edhe pse jemi favoritë ne duhet t'i qasemi ndeshjes me seriozitetin më të madh. Besoj shumë ne rezultat të mirë", ka thënë Ujkani.

Risi për dy ndeshjet e këtij muaji në listën e trajnerit Challandes

është edhe sulmuesi Lirim Kastrati, i cili është duke shkëlqyer në këtë edicion me fanellën e Lokomotiva Zagrebit në Kroaci. "Ishte ëndërr e imja që të luaja për Përfaqësuesen A dhe kjo u bë realitet. Më kanë pritur jashtëzakonisht mirë. Do të përpiqem ta jap maksimumin tim nëse do të vendos përzgjedhësi që të më inkuadrojë dhe nuk është me rëndësi se nga cila minutë filloj", ka thënë Kastrati. Ndërsa të martën Federata e Futbollit e Kosovës ka njoftuar opinion publik se dyert e stadiumit "Fadil Vokrri" për ndeshjen Kosova - Malta do të hapen në orën 18:00. Sipas FFK-së, asnjë person, përfshirë edhe fëmijët, pavarësisht prej moshës së tyre, nuk do të lejohet të hyjë në zonën e stadiumit pa biletë. "Në hyrjet e stadiumit si dhe brenda stadiumit do të aplikohen masa të rrepta kontrolli, prandaj lutem të gjithë qytetarët që t'i lexojnë me kujdes rregullat e mëposhtme dhe t'i respektojnë kërkesat. Qytetarët të cilën nuk i përfillin rregullat e sigurisë mund të jenë subjekt për ndëshkim nga organet ligjore",

thuhet në njoftimin e FFK-së. Gjërat që nuk lejohen në stadium dhe se do të konfiskohen në hyrje janë: Mjetet piroteknike, shishet e qelqit, pavarësisht prej madhësisë, shishet e plastikës, pavarësisht prej madhësisë, pijet alkoolike dhe substancat narkotike, ushqim i çfarëdo lloji (përveç ushqimit të fëmijëve 24 muajsh) si fara, çipsi, smoki, kikirikë, lajthi, badem etj., ombrella, armë zjarri ose armë të ftohta, sende të rënda (çanta shpine, karrige të palosshme etj.), kamera profesionale dhe

videokamera, pajisjet elektronike, mekanike ose manuale, që prodhojnë zhurmë, si megafonë, bori ose vuvuzele, materialet promovuese ose komerciale, çdo material promovues racist, ksenofobik, politik, fetar.

FFK-ja s'bën zë që lulëzon tregu i zi i shitjes së biletave

Tradita për të siguruar një biletë për ta përcjellë nga afër Përfaqësuesen e Kosovës në futboll vazhdon të jetë e njëjtë.

Pavarësisht se Federata e Futbollit kishte paralajmëruar se gjithçka do të shkojë në mënyrën më të mirë dhe nëpërmjet sistemit online, kjo nuk po ndodh as tash dhe tregu i zi është duke lulëzuar më të madhe, por edhe duke mbetur mundësia e vetme për të siguruar një biletë për ta përcjellë ndeshjen Kosova - Malta, e cila zhvillohet të enjten në stadiumin "Fadil Vokrri". Çmimi zyrtar i biletave ka qenë 2, 3, 5 dhe 10 euro, kurse në tregun e zi çmimi i tyre është shumëfishuar, pra nga 15 deri në 25 euro.

Llapi dhe Ferizaj dënohen me nga 1 000 euro



PRISHTINË, 9 TETOR - Komisioni Disiplinor i Shkallës së Parë i Federatës së Futbollit të Kosovës i ka dënuar dy skuadrat e IPKO Superligës, Llapin dhe Ferizajn, me nga 1 000 euro. Skuadra e Llapit

është dënuar për shkak të fyerjeve në kor nga shikuesit e saj drejtuar ekipit mysafir dhe hedhjen e gjësendeve në fushë, kurse Ferizaj është dënuar me arsyen se për lëshime në organizimin e

ndeshjes dhe hedhjen e një shporte me mbeturina nga ana e shikuesve në drejtim të asistentit të dytë Artan Latifi. Ndërsa skuadrës së Prishtinës i është tërhequr vërejtja për futjen e shikuesve në terren për ta


festuar golin. Nga futbollistët që ka pësuar dënim është Bujar Idrizi, i cili nuk ka të drejtë të luajë në dy ndeshjet e radhës për shkak të ndëshkimit me karton të kuq dhe sjellje josportive.

Qeveria miraton kërkesën për kompleksin sportiv të Prishtinës

PRISHTINË, 9 TETOR - Qeveria e Republikës së Kosovës të martën e miratoi kërkesën e Ministrisë për Kulturë, Rini e Sport që të zgjerohet hapësira e parcelës së kërkuar nga FC Prishtina për shfrytëzim. "Qeveria Haradinaj, në mbledhjen e saj të radhës, i ka dhënë

dritën jeshile kërkesës së Ministrisë së Sportit që të zgjerohet hapësira e parcelës së kërkuar nga FC Prishtina për shfrytëzim. Me propozimvendimin e ri, bardhekaltrit do t'i kenë në dispozicion 100 mijë metra për ndërtimin e kompleksit të madh dhe modern

sportiv, që planifikojnë ta bëjnë prishtinasit. Pra, gati një fish më shumë në krahasim me vendimin paraprak, në bazë të të cilit prishtinasit do t'i kishin në dispozicion pak më shumë se 50 mijë metra katrorë", thuhet në njoftimin e Prishtinës.



Hitzfeldi arsyeton shqiptonjat e Xhakës dhe Shaqirit

CYRIH, 9 TETOR - Trajneri legjendar i Zvicrës, Ottmar Hitzfeld, ka folur për shqiptonjtë e Granit Xhakës dhe Xherdan Shaqirit në Kampionatin Botëror që u mbajt në Rusi. Trajneri zviceran

ka thënë për gazetën e përditshme "Blick", se ato ishin reagime të momentit dhe nuk ka asgjë për t'u zmadhuar. "Ishte një ventil që ata e hapën. Shoh shpesh ngjashmëri edhe në

rastet e Gjermanisë. Golat ishin një goditje çlirim, lojtarët nuk e tejkaluan gjatë festimit - për këtë nuk duhet të diskutohet shumë", ka thënë Hitzfeldi. "Unë isha në ndeshje dhe nuk

ka qenë reagim ndaj tyre", ka thënë ish-trajneri i Zvicrës, duke mos dashur të thellohet në fyerjet që u kishin bërë tifozët serbë, lojtarëve me prejardhje nga Kosova.



Delegacioni i Kosovës feston për medaljen e Erza Muminoviçit

PRISHTINE, 9 TETOR - Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK), bashkë me Ministrinë për Kulturë, Rini e Sport (MKRS), si dhe tërë ekipin Olimpik të Kosovës, kanë festuar në Buenos Aires medaljen historike të Kosovës nga Lojërat Olimpikë për të Rinj (LOR), "Buenos Aires 2018". Xhudistja Erza Muminoviçi fitoi të bronzën në kategorinë -44 kilogramë, në debutimin e Kosovës në LOR.

Presidenti i KOK-ut, Besim Hasani, theksoi se pas medaljes së fituar në Lojërat Evropiane nga xhudistja Nora Gjakova të artës së Majlinda Kelmendit në LO RIO 2016, edhe 7 tetori 2018 do të hyjë në historinë e Lëvizjes Olimpikë në Kosovë. "Erza Muminoviçi bëri që të krenohet çdo shqiptar kudo që është. Ky sukses normalisht i dedikohet trajnerit të xhudos, Driton Kukës. Atje ekziston një ekip, nuk është vetëm Dritoni, janë edhe trajnerët Fatos Tabaku, kryetari i federatës (Agron Kuka) dhe gjithë ata që punojnë me një plan strategjik, me një strategji që befason gjithë botën. Konsiderata e KOK-ut ndaj punës që bëhet në Federatën e Xhudos së Kosovës (FXHK) është e jashtëzakonshme dhe në këtë



drejtim krejt mirënjohjet i përcillen FXHK-së, por aktorja kryesore këtu është Erza, të cilën duam ta përgëzojmë", ka thënë kryetari i KOK-ut, Besim Hasani. "Ky takim është organizuar për ta respektuar ekipin olimpik, Erzën, për rezultatin e saj të jashtëzakonshëm, me dëshirën më të mirë që edhe ju sportistët e tjerë ta jepni maksimumin nga kapaciteti që e keni dhe nëse e bëni këtë, do t'ju konsiderojmë fitues të medaljes", ka shtuar Hasani.

Ndërsa ministri Kujtim Gashi shprehu kënaqësinë e të qenit pranë sportistëve në Buenos Aires, në veçanti për ta festuar medaljen e bronzë të Erzës. "Për mua është hera e parë që ndod-

hem në një ngjarje të nivelit të tillë. Medaljen e Majlindës e kam përjetuar nga një pozitë tjetër, ndërsa të Erzës si ministër, për çka më bën të ndihem mirë. Në të njëjtën kohë inkurajoj edhe sportistët e tjerë që me punë dhe angazhim ta ndjekin rrugën e Erzës me rezultate të mira. Po e shoh se është një ekip që premtion shumë dhe kjo energji që kanë do të na sjellin rezultate më të mira në të ardhmen", ka thënë ministri Gashi.

Kosova po përfaqësohet në LOR Buenos Aires 2018 me pesë sportistë: Erza Muminoviçi (xhudo), Melisa Zhdrella (not), Erdonis Maliqi (boks), Bleron Fetaovski (peshëngritje) dhe Muhamet Ramadani (atletikë).

Formula 1 zbarkon në Vietnam

HANOI, 9 TETOR - Vietnami kërkon të organizojë një garë të Formulës 1, madje ka vendosur si afat vitin 2020 për ta zhvilluar garën e parë. Lajmin e ka konfirmuar nëpërmjet revistës së njohur "Autosport" drejtori i garave të Formulës 1, Charlie Whiting. Marrëveshja mes Qeverisë së Vietnamit dhe pronarëve të Formulës 1 mund të vijë që në nëntor të këtij viti, pas për-



drejtuesve të këtij sporti, është më spektakolare se një pistë e ndërtuar në periferi. Drejtuesit e Formulës 1 kanë vizituar zonën para garës së Japonisë që u zhvillua javën e kaluar dhe kanë mbetur të kënaqur nga ideja. "Punimet nuk kanë nisur ende, por është evidentuar zona ku do të zhvillohet gara dhe projekti është në një fazë të avancuar. Vietnami mendon se gjithçka do të jetë gati brenda vitit 2020", ka thënë Whitingu.

fundimit të Botërorit, edhe pse një paramarrëveshje është arritur që më parë. Kjo do të jetë një garë qytetase, në Hanoi që, sipas

Hamiltoni: Tregoni më shumë respekt për Vettelin

Fundjava japoneze në Formulën 1 ishte krejtësisht për t'u harruar për Sebastian Vettelin. Piloti gjerman bëri disa gabime dhe e mbylli në vendin e 6 garën, ndërsa titulli botëror tashmë është një mirazh për të. Kritikat ndaj katër herë kampionit të botës janë shtuar, megjithatë Velteli e ka dikë që e mbron dhe nuk është as më

shumë e as më pak, por vetë rivali i tij Lewis Hamilton, i cili nëpërmjet një postimi në "Instagram" ka kërkuar më shumë respekt për Sebastian Vettelin. "Besoj se media duhet të tregojë më shumë respekt për Vettelin. Nuk mund ta imagjinojmë sa e vështirë është ajo që bëjmë ne, në këto nivele. Është e vështirë për çdo sportist që

është në kulmin e aktivitetit. Është e kuptueshme që ne, si njerëz që jemi, mund të bëjmë gabime. Ajo që ka rëndësi është se si i korrigjojmë", lexohet në postimin e Lewis Hamiltonit. Një mesazh ky që te Ferrari shpresohet që të ndihmojë në moralin e Vettelit dhe në përmirësimin e paraqitjeve të tij në pistë.

SHKURT

Realit e kërkoi mesfushorin 37-vjeçar të Betisit

Realit i Madridit në afatin kalimtar të verës kërkoi shërbimet e mesfushorit 37-vjeçar të Real Betisit, Joaquin, por transferimi dështoi për shkak të kërkesës së lartë financiare nga klubi i Betisit për ta lënë të lirë futbollistin. Këtë lajm e ka konfirmuar vetë futbollisti në një intervistë për "Onda Cero". Ai tregon se pritet të grumbullohet nga kombëtarja e Spanjës, edhe pse është 37-vjeçar. "Presidenti Lopera e dinte se dëshira ime ishte që të luaja me Real Madridin, sepse kjo ishte një mundësi e artë për mua. Por, Betisi kërkoi një shumë të lartë parash dhe kësaj transferimi dështoi. Unë isha duke pritur deri në momentin e fundit thirrjen e Luis Enrique për përzgjedhjen time. Kombëtarja është diçka që unë e dua dhe shpresa është gjithmonë, edhe pse unë jam realist dhe e di se është shumë e komplikuar", ka thënë Joaquin.

Griezmanni: 'Topin e Artë' duhet ta fitojë një francez

Sulmuesi i Atletico Madridit, Antoine Griezmann, ka shprehur mendimin se lojtari më i mirë në botë duhet të zgjidhet nga ekipi Kombëtar i Francës. Franca triumfoi në Kupën e Botës, kurse Paul Pogba, Kylian Mbappë, Hugo Lloris dhe Antoine Griezmannin janë të nominuar për "Topin e Artë". "Lojtari më i mirë në botë duhet të vijë nga ekipi më i mirë në botë. Ekzistojnë gjykime dhe mendime të ndryshme, por mendoj se një lojtar francez duhet ta fitojë 'Topin e Artë'. Ne e kemi fituar Kupën e Botës", ka thënë Griezmann.

Ventura, trajner i ri i Chievos

Skuadra nga Verona e ka nisur shumë dobët sezonin e ri në Serinë A. Gian Piero Ventura rikthehet të drejtojë një skuadër, sigurisht jo në nivel kombëtar. Trajneri veteran italian është emëruar në krye të Chievos në Serinë A. Shkarkimi i trajnerit Lorenzo D'Anna u zyrtarizua nga klubi veronez, ndërsa presidenti Campedelli e kishte gjetur një emër të denjë për zëvendësimin e tij. Iacchini ishte emri i parë i kontaktuar, por palët nuk e gjetën gjuhën e përbashkët, kështu që numri një i Chievos ia besoi skuadrën trajnerit veteran, i cili, së fundmi, kishte drejtuar kombëtaren italiane, por dështoi ta kualifikonte në Kampionatin Botëror, "Rusia 2018".

Buffoni: Mund të luaj deri në moshën 50-vjeçare

Karriera e Gianluigi Buffonit mund të zgjasë edhe 10 vjet të tjera. Duket diçka në kufijtë e të pabesueshmes, por është vetë portieri 40-vjeçar që e deklaroi diçka të tillë. Buffoni po përjeton një rini të dytë te PSG-ja dhe ndihet shumë i lumtur te kampionët e Francës. Kontrata që ka nënshkruar me klubin parisien është 1+1, por Buffoni nuk dëshiron të ndalet me kaq dhe në një intervistë për mediet franceze e thotë me bindje këtë gjë: "Të luaj deri në moshën 50-vjeçare? Pse jo, kur isha 32-vjeçar mendoja se do ta lija futbollin në moshën 35-vjeçare. Kur arrita në atë moshë mendova ta lija kur të bëhesha 38 e, kur shkova 38, thashë po e shty deri 40. Ja ku jam, me të njëjtën dëshirë, për të luajtur si në fillimet e mia".

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► "Kosovo-Nickel" L.L.C. shpallë të pavlefshme certifikatën e biznesit me seli në Glogoc, me nrb. 71107035.

► Kabir Bajra shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII SHF "Leke Dukagjini" Prizren

► Penarta Kryeziu shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHMM "Lorenc Antoni" Prizren.

► Arlind Bujari shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX SHFMU "Matilo Goreci" Prizren.

► Sadam Sallami shpall te pavlefshme dëftesat certifikatat diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren.

► Liridona Ballazhi shpall te pavlefshme diplomën e SH.M.L "Dardania" Hani Elezit.

► Lendita Llapashtica nga Prishtina, shpallë të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Ali Sokoli" Prishtinë.

► Venera Rrahmani shpallë të pavlefshme, dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme "Sami Frashëri" Prishtinë.

► Dr. Arben Beka shpall të pavlefshme licencën e punës nr. KO-05670-01, lëshuar në Prishtinë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2), të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenin 38 të Ligjit Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 82, dt. 21 tetor 2010), duke u bazuar në nenin 17 (paragrafi 5 dhe paragrafi 6) të rregullores Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), në pajtim me nenin 5 (paragrafi 5.4. c) të Rregullores 2001/19, si dhe Rregullores MF-NR-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik për OJQ-ve, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë, bënë:

Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/ programeve të OJQ-ve që kontribuojnë në bujqësi, zhvillimit rural dhe pylltarisë

1. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural u bënë thirrje organizatave jo-qeveritare të Regjistruara në Republikën e Kosovës (MAP), programi i të cilave është në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural dhe pylltarisë, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në zhvillimin e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural në:

- ✓ Trajnime profesionale në hartimin e projekteve në Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
- ✓ Këshilla profesionale në sektorin e bujqësisë,
- ✓ Kampanja informative, tryeza, seminare dhe punëtori për bujqësi pylltari dhe zhvillim rural,
- ✓ Promovimi i prodhimeve bujqësore përmes ekspozitave dhe panairëve,
- ✓ Aktivitete të karakterit garues në lëmi të bujqësisë,
- ✓ Ditë fushore.

2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet/ programet e tyre për fushat prioritare si në vijim:

1. Zhvillimin e interesit publik në fusha të caktuara bujqësore;
2. Kapacitetet e organizatës, grupeve të marginalizuara;
3. Shoqatave të prodhuesve dhe përpunuesve bujqësor vendor në realizimin e projektit - programit;
4. Programe në rritjen e cilësisë dhe sasisë së produkteve bujqësore;
5. Zhvillimit të kapaciteteve të fermerëve/fermereve ekzistues, si dhe atyre që pretendojnë të jenë fermerë të rinj, apo palëve tjera të interesit në bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural në hartimin, menaxhimin dhe zbatimin e projekteve, menaxhimin e cilësisë, inovacioneve apo çështje tjera me interes në funksion të përmirësimit të njohurive të grupeve të interesit.

3. Organizatat jo-qeveritare mund të aplikojnë me një projekt që kontribuojnë në zhvillimin rural, bujqësisë dhe pylltarisë, përmes aktiviteteve si më poshtë:

Aktivitete që synojnë avancimin e bashkëpunimit në mes të OJQ-ve dhe institucioneve publike në përmirësimin e gjendjes së fermerëve në sektorët e: Forcimin e kapaciteteve të OJQ për të punuar në promovimin e produkteve bujqësore.

- prodhimin,
- përpunimit,
- tregtimin,
- marketingut promovimit të produkteve vendore,
- turizmi rural.

4. Vlera totale financiare e planifikuar e thirrjes është 100,000.00 €.

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt individual është 2,000.00 €, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 5,000.00 €.

5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune, duke filluar me datën 10.10.2018 dhe përfundon me datën dhe 30.10.2018.

6. OJQ-të mund të aplikojnë me një projekt në kuadër të kësaj thirrje, nga fushat prioritare sipas thirrjes. Periudha e zbatimit të projektit është për 6 muaj.

Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-qeveritare në Republikën e Kosovës - Ministrinë e Administratës Publike dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural dhe pylltarisë.

OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit, si dhe të kenë përbushur detyrimet kontraktuale ndaj MBPZHR-së dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqes prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën vepra penale dhe nuk janë dënuar për vepra penale (për fushëveprimtarinë e OJQ-së), si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

7. Propozimet dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët janë në dispozicion në faqen e internetit www.mbpzhr-ks.net.

Dokumentet e kompletuara dërgohen me postë ose personalisht, në adresën e mëposhtme: Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Rr. "Nëna Tercëzë" Nr. 35, 10000 Prishtinë.

1. Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi

i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

2. Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.
3. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: Fatime.Ionuzi@rks-gov.nct.

Na osnovu člana 145 (stav 2) Ustava Republike Kosovo, uzimajući u obzir član 38 Zakona Br. 03 / L-189 o Državnoj Administraciji Republike Kosovo (Službeni list Br. 82, od 21. oktobra 2010. godine), na osnovu člana 17 (stav 5 i stav 6) Uredbe Br. 02/2011 o oblastima administrativne odgovornosti Kancelarije Premijera i Ministarstava (22.03.2011), u skladu sa članom 5 (stav 5.4.c) Uredbe 2001/19, kao i Uredbom MF-BR-04/2017 o Kriterijumima, Standardi i Procedure Javnih Finansija za NVO, Generalni Sekretar Ministarstva Poljoprivrede, Šumarstva, izadaje:

Javni poziv za pružanje javne finansijske podrške za finansiranje projekata / NVO programa koji doprinose poljoprivredi, ruralnom razvoju i šumarstvu

1. Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja pozvala je nevladine organizacije registrovane u Republici Kosovo (MJA), čiji je program u oblasti poljoprivrede, ruralnog razvoja i šumarstva, da apliciraju za finansijsku podršku za projekte koji doprinose razvoju, poljoprivredi, šumarstvu i ruralnom razvoju u:

- ✓ Profesionalne obuke o nacrtu projekata u Poljoprivredi, Šumarstva i Ruralnog Razvoja Profesionalni Saveti u sektoru poljoprivrede,
- ✓ Informativne kampanje, okrugli stolovi, seminari i radionice o poljoprivredi, šumarstvu i ruralnom razvoju,
- ✓ Promocija poljoprivrednih proizvoda kroz izložbe i sajmove,
- ✓ Aktivnosti takmičarskog karaktera u oblasti poljoprivrede,
- ✓ Dan kampanje.

2. NVO, u skladu sa ovim javnim pozivom mogu aplicirati sa svojim projektima/ programima za sledeće prioritete oblasti:

- 2.1. Razvoj javnog interesa u određenim poljoprivrednim oblastima;
- 2.2. Kapaciteti organizacije, marginalizovanih grupa;
- 2.3. Udruženja domaćih proizvođača i prerađivača u implementaciji projekta-programa;
- 2.4. Programi za povećanje kvaliteta i količine poljoprivrednih proizvoda;
- 2.5. Razvoj kapaciteta farmera/ postojećih farmera kao i onih koji tvrde da su mladi farmeri ili drugi akteri interesa u poljoprivredi, šumarstvu i ruralnom razvoju u nacrtu, upravljanju i implementaciji, upravljanju kvalitetom, inovacijama ili druga pitanja interesa u cilju poboljšanja znanja grupama interesa.

3. Nvladine organizacije mogu aplicirati sa jednim projektom koji doprinosi ruralnom razvoju, poljoprivredi i šumarstvu kroz sledeće aktivnosti:

Aktivnosti koji ciljaju napredak saradnje između NVO-a i javnih institucija u poboljšanju položaja farmera u sektorima: Jačanje kapaciteta NVO-a za rad na promociji poljoprivrednih proizvoda.
proizvodnje,
prerade,
trgovanje,
marketinga promociji domaćih proizvoda,
i ruralnog turizama;

4. Ukupna planirana finansijska vrednost poziva je 100.000,00 €.

Minimalni iznos finansijske podrške koji se može izdvojiti za svaki pojedinačni projekat je 2.000,00 €, a maksimalni iznos za jedan projekat iznosi 5.000,00 €.

5. Zadnji rok za podnošenje predloga je 15 radnih dana, od 10.10.2018 do 30.10.2018.

6. NVO mogu aplicirati sa projektom unutar ovog poziva iz prioritarnih oblasti u skladu sa pozivom. Period implementacije projekta je 6 meseci.

Pravo na aplikaciju imaju pravo nevladine organizacije (NVO) koje su registrovane u registru nevladinih organizacija u Republici Kosovo - Ministarstvo za Javnu Administraciju i koje posluju u Republici Kosovo. NVO kandidati moraju dokazati da je njihov program rada fokusiran u oblasti poljoprivrede, ruralni razvoj i šumarstvo.

NVO bi takođe trebale izvršiti finansijske transakcije na transparentan način u skladu sa zakonodavstvom za NVO u Republici Kosovo i u skladu sa računovodstvenim pravilima i ispunjavale ugovorne obaveze prema MPSRR-u i svim drugim ponudama finansijske javne podrške.

Pre potpisivanja ugovora, nevladina organizacija mora (NVO) dostaviti dokaze da odgovorna osoba u NVO-u i rukovodilac projekta nisu krivica dela i da nisu osuđeni za krivično delo (za obim delovanja NVO-a), kao i dokaze da je NVO riješila otvorena pitanja o plaćanju neplaćenih doprinosa i poreza, ako je primenljivo.

7. Predlozi se dostavljaju samo na predviđenim obrascima, koji zajedno sa Upustvima za aplikante dostupni su na veb stranici www.mbpzhr-ks.net.

Dovršeni dokumenti se šalju poštom ili lično na sledeću adresu: Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja, Ul. Majka Tereza Br. 35, 10000 Priština

1. Proces primanja, otvaranja i razmatranja aplikacija, procene aplikacija, ugovaranja, da vanje fondova, vreme i način podnošenja žalbi, obrade dokumenata i indikativnog kalendara implementacije poziva detaljno su opisani u Upustvima za aplikante javnog poziva.
2. Razmatraće se za finansijsku podršku samo projekti koji su primljeni unutar predviđenog roka ovim javnim pozivom i koji u potpunosti ispunjavaju određene uslove javnog poziva.
3. Sva pitanja koja se vezuju sa javnim pozivom mogu se razjasniti samo elektronskim putem, slanjem e-mail na adresi: Fatime.Ionuzi@rks-gov.nct.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

THIRRJE PUBLIKE PËR SHPREHJE INTERSIT PËR TË QENË PJESË E KOMISIONEVE VLERËSUESE PËR VLERËSIMIN E PROJEKTPROPOZIMEVE TË OJQ-VE

Ministritë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural gjatë viti 2018, bazuar në Rregulloren e MF-NR-04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik për OJQ-të planifikon që përmes thirrjes publike të ofrojë mbështetje financiare për implementimin e projekteve të organizatave jo-qeveritare në fushat që ndërlihen me:

1. Zhvillimin e interesit publik në fusha të caktuara BPZHR;
2. Kapacitetet e organizatës, grupeve të marginalizuara;
3. Shoqatave të prodhuesve dhe përpunuesve bujqësor vendor në realizimin e projektit, respektivisht programit;
4. Programe cilësore në rritjen e cilësisë dhe sasisë së produkteve bujqësore;
5. Zhvillimit të kapaciteteve të fermerëve/fermereve ekzistues, si dhe atyre që pretendojnë të jenë fermerë të rinj, apo palëve tjera të interesit në bujqësi, zhvillim rural dhe bujqësi në shkruarjen dhe menaxhimin e projekteve, menaxhimin e cilësisë, inovacioneve apo çështje tjera me interes në funksion të përmirësimit të njohurive të grupeve të interesit;
6. Projektet të cilat kanë për qëllim forcimin e kapaciteteve të OJQ-ve për të punuar në promovimin e produkteve bujqësore, zhvillim rural dhe bujqësinë;
7. Projektet të cilat janë të fokusuar në punë me grupet e fermerëve/fermereve, fermerëve të rinj, fermave të vogla, si dhe komunitetit të fermerëve;
8. Projektet të cilat synojnë avancimin e bashkëpunimit në mes të OJQ-ve dhe institucioneve publike në përmirësimin e situatës së prodhimit, përpunimit, promovimit të produkteve vendore, trashëgimisë kulturore; mbrojtjes së fëmijës dhe të drejtave të tyre.

Rregulloren e MF-NR-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik për OJQ-të, sipas nenit 8, paragrafi 3.2 parasheh që pjesë e çdo komisioni vlerësues për vlerësimin e projekt-propozimeve të OJQ-ve të pranuar sipas thirrjeve publike, duhet të jenë dy përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtë, duke përfshirë përfaqësues të OJQ-ve. Për këtë qëllim MBPZHR fton të gjithë kandidatët e interesuar që të aplikojnë për të qenë pjesë e regjistrit të ekspertëve të jashtëm, të cilët sipas nevojës së institucionit do të caktohen në cilësinë e anëtarëve të komisioneve vlerësuese për të vlerësuar projekt-propozimet e dorëzuara nga OJQ-të për financim përmes fondeve publike.

Të drejtë aplikimi kanë:

- Të punësuarit/rat në organizatat joqeveritare aktive në Republikën e Kosovës;
- Ekspertë/c të pavarur/a, të cilët/cilat kanë të paktën 5 vite përvojë pune që ndërlihen me administratën publike, hartimin dhe menaxhimin e projekteve apo fusha të ngjashme.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- Duhet së paku të kenë të kryer nivelin e studimeve Bachelor;
- Të kenë së paku 5 vite përvojë pune;
- Të kenë përvojë me projekte të OJQ-ve;
- Të mos jenë të emëruar politikë, shërbyes civil apo pozita të ngjashme në administratën shtetërore.

Të interesuarit për aplikim për anëtar të komisionit duhet t'i plotësojnë kërkesat e përgjithshme të Ftesës Publike:

1. Përvojë në vlerësimin e kërkesave të paraqitura në thirrjet për mbështetje financiare nga burimet publike;
2. Njohja e dokumenteve strategjike dhe politikave prioritet në fushën e bujqësisë;
3. Njohja e bazës ligjore në fuqi në fushat që mbulon MBPZHR;
